



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 17 SHTATOR 2020, TIRANË

**PROCESVERBAL**

**SEANCËN E DREJTON**  
**KRYETARI I KUVENDIT**  
**GRAMOZ RUÇI**

*(Seanca filloi në orën 10:00)*

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 07.09.2020 *(neni 44, pika 2, i Rregullores)*

2. Njoftimi i çështjeve të depozituara në Kuvend për shqyrtim *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Interpelancë me ministrin e Turizmit dhe Mjedisit, kërkuar nga deputeti Vasil Sterjovski *(neni 80 i Kushtetutës dhe neni 96 i Rregullores)*

4. Projektligji “Për aderimin në amendamentin DOHA të protokollit të Kiotos të konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike, aderuar me ligjin nr. 9334, datë 16.12.2004” *(neni 121 i Kushtetutës dhe*

*nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit në parim, nen/nen dhe në tërësi

5. Projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”, ratifikuar me ligjin nr. 100/2017” *(neni 121 i Kushtetutës dhe nenet 55*

dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit në parim, nen/nen dhe në tërësi

6. Projektvendimi “Për krijimin dhe përbërjen e komisionit të posaçëm parlamentar të shqyrtimit dhe përzgjedhjes së kandidaturave për organet drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionit Rregullator, Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, si dhe për Nënkomisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve” (neni 78 i Kushtetutës, neni 55 i Rregullores dhe neni 17 i ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, votim i hapur, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

**Gramoz Ruçi** – Seancën e ditës së sotme e deklaroj të hapur.

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Ka vërejtje lidhur me procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet.

A ka ardhur ministri?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, urdhëroni!

**Arben Elezi** – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Javën e kaluar në medie u shfaqën dy raste të tjera të rënda të abuzimit seksual me të mitur, duke hapur kështu një debat të gjerë për një shqetësim...

**Gramoz Ruçi** – Ju lutem, çfarë e keni këtë? Përse e kërkuat fjalën?

**Arben Elezi** – Kërkesë e kam.

**Gramoz Ruçi** – Kërkesë për çfarë?

**Arben Elezi** – E kam për procedurë në lidhje me abuzimet me të miturit.

**Gramoz Ruçi** – Për procedurë?! Nuk është procedurë abuzimi, është deklaratë.

Duhej të bëje një kërkesë që kishe një deklaratë dhe ta jepja fjalën kur të të vinte radha, por jo për procedurë.

**Arben Elezi** – Okej, edhe ashtu mund ta bëjmë.

**Gramoz Ruçi** – Kush e do fjalën tjetër për procedurë?

Urdhëroni! Ju lutem, IT-ja, te rreshti i fundit.

**Zef Shtjefni** – Faleminderit, zoti Kryetar!

E kërkoja fjalën për t'i bërë një urim ministres së re të Arsimit për detyrën e lartë që ka marrë. Si deputet i opozitës parlamentare, i pandikuar nga askush, gjej rastin t'i uroj suksese në detyrë, një detyrë e rëndësishme për shkollimin dhe edukimin e gjeneratës së re...

**Gramoz Ruçi** – E para, mos u nxitoni, se nuk është procedurë kjo!

E dyta...

**Zef Shtjefni** – Kisha...

**Gramoz Ruçi** – Ju lutem, avash!

**Zef Shtjefni** – Një minutë, se...

**Gramoz Ruçi** – A ka mundësi të mësosh një herë?

**Zef Shtjefni** – Po, urdhëroni!

**Gramoz Ruçi** – A ka mundësi?

**Zef Shtjefni** – Do të dal diku tjetër unë.

**Gramoz Ruçi** – Jo, nuk ke pse del në vend tjetër, sepse pritet vota jote që ta urosh pastaj. Nuk ka dalë dekreti ende. Do të vijë në parlament, do të votojmë edhe ti, edhe unë, pastaj do ta urojmë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

I dashur, e ke marrë fjalën për procedurë, por uron ministren e Arsimit që nuk ka ardhur në parlament!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Çfarë ke për procedurë, thuaje.

**Zef Shtjefni** – Doja të flisja për ministren që merr detyrën dhe për ministren që iku. Kisha dy fjalë për ministren që iku, sepse, pavarësisht problemeve që kishim ne dhe e kemi kritikuar disa herë, edhe ajo i ka dhënë diçka Shqipërisë, ndërkohë edhe Shqipëria i dha asaj detyrën e ministres, një detyrë nderi e lartë. Zonja Shahini kishte një merak për gjuhën, por zonja Shahini e fliste shumë bukur gjuhën shqipe, atë shqipe që kanë folur dhe kanë shkruar Padre Gjergj Fishta, Dom Ndre Mjeda dhe Luigj Gurakuqi.

Kaq kisha.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Atëherë, vazhdojmë me interpelancën me ministrin e Turizmit dhe Mjedisit, e kërkuar nga deputeti Sterjovski, lidhur me situatën ekologjike në liqenin e Prespës. Sikurse është vepruar edhe në sesionin e kaluar, për shkak të situatës, do të përgjysmohet koha. Prandaj ia jap fjalën deputetit Sterjovski 3 minuta e gjysmë për të parashtruar interpelancën.

**Vasil Sterjovski** – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Interpelancën me ministrin e Turizmit dhe Mjedisit, zotin Blendi Klosi, e kërkoja për katastrofën ekologjike që i kanoset liqenit të Prespës dhe për menaxhimin e fondeve në Parkun Kombëtar të Prespës.

Liqenit të Prespës, për shkak të thatësisë dhe ndryshimeve klimaterike, po i kanoset një katastrofë ekologjike dhe nga viti 2018 e deri sot ujë ka shteruar në një lartësi prej 5 metrash dhe është tërhequr të paktën 200 metra, krahasuar me vijën fillestare të ujit. Liqeni i Prespës shtrihet në kufijtë shtetërorë të Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, dhe është një problem që prek të tria shtetet që ndajnë bregun e liqenit, rrjedhimisht duhen ndërmarrë aksione të

përbashkëta për ngadalësimin e kësaj fatkeqësie natyrore.

Për ta ilustruar si paraqitet sot situata në liqenin e Prespës, po tregoj dy fotot nga pjesa shqiptare e këtij liqeni në afërsi të fshatit Goricë. Fotoja e parë është fotografuar në vitin 2018, ndërsa në foton e dytë është fotografuar i njëjti vend këtë javë, ku shihet se e gjithë pjesa në anën e Goricës është tërhequr dhe po vazhdon të tërhiqet.

Pyetjet e mia për zotin ministër janë: a po e monitoron Ministria e Turizmit dhe Mjedisit tërheqjen e ujit në liqenin e Prespës dhe si paraqitet situata? A ka menduar dhe a ka planifikuar Ministria e Turizmit dhe Mjedisit masa, studime, programe apo projekte konkrete së bashku me institucionet përkatëse të Maqedonisë së Veriut dhe të Greqisë për të parandaluar uljen alarmante të nivelit të ujit në liqenin e Prespës?

Për shkak të biodiversitetit të pasur, në vitin 1997 është shpallur Parku Kombëtar i Prespës. Në këta 20 vjet nga krijimi i Parkut Kombëtar të Prespës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me donatorët e huaj, ka zbatuar projekte të ndryshme për Parkun Kombëtar të Prespës nëpërmjet të cilave është synuar mbrojtja e mjedisit, ndërgjegjësimi i komunitetit, ngritja e kapaciteteve të administratës së Parkut Kombëtar të Prespës, rritja e numrit të turistëve, përmirësimi i jetës së banorëve, studime të ndryshme e të tjera, të cilat kanë kapur vlerën e miliona eurove. Të gjitha këto projekte nuk kanë kontribuar në zbutjen e varfërisë në zonë dhe as në mbrojtjen e mjedisit në Parkun e Prespës, ku në 90% e territorit të tij i përket Bashkisë së Pustecit.

Në bazë të marrëveshjes, qeveria gjermane financoi me një grant prej 3,5 milionë eurosh fazën e dytë të projektit "Rezervati ndërkufitar i biosferës Prespë" me një kohëzgjatje nga viti 2016 deri në vitin 2020. Qëllimi i projektit ishte të reduktonte shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe uljen e varfërisë në pjesën e Shqipërisë të rezervës së biosferës së Prespës, si dhe ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë në Parkun e Prespës. Ky është viti i katërt i zbatimit të këtij projekti dhe nuk ka asnjë investim të vërtetë në territorin e Parkut të Prespës të mbështetur nga ky projekt. Pyetjet e mia për këtë problematikë për zotin

ministër janë: a i ka kontrolluar dhe a ka kërkuar llogari Ministria e Turizmit dhe Mjedisit se si janë shpenzuar fondet e këtyre projekteve apo edhe të projektit aktual që po zbatohet "Rezervati ndërkufitar i biosferës Prespë"? A nuk duhen menaxhuar krejt ndryshe këto projekte që t'i shërbejnë mirëqenies së komunitetit, i cili jeton në territorin e Parkut të Prespës?

(*Bie gongu.*)

Mos ka ardhur koha që fondet e këtyre projekteve të mos shkojnë për ekspertë të huaj, seminare, konferenca, hartimin e strategjive të ndryshme, dreka, por të investohen në gjëra konkrete që i nevojiten komunitetit, si zgjidhjen e problemit të ujërave të zeza, të menaxhimit të mbetjeve urbane apo agroturizmit?

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Fjalën e ka ministri Klosi.

Zoti Klosi, keni në dispozicion 10 minuta.

**Blendi Klosi** – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Do të doja realisht të falënderoja deputetin dhe ju për kohën që na jepni për të diskutuar në parlament një çështje realisht tejet të rëndësishme që ka të bëjë me biodiversitetin, me ruajtjen e një pasurie aq të madhe që ka e gjithë zona e Prespës dhe Bashkia e Pustecit, si një nga zonat më të përfshira në të, natyrisht, edhe për të folur edhe për një problem shumë të madh mjedisor që është ngrohja globale. Pa dyshim, Shqipëria është vend shumë i vogël për të ndikuar në efektet e ngrohjes globale në të gjithë botën. Madje, besoj se jo vetëm Ministria e Mjedisit të Shqipërisë, por çdo ministri mjedisi në botë, edhe në vendet më të fuqishme të botës, diskutojnë për mungesa të mëdha në kapacitete njerëzore për të luftuar dhe për të fituar një betejë të jashtëzakonshme, në të cilën e gjithë bota duhet të jetë e përfshirë. Megjithatë, e gjithë bota tashmë diskutojnë shumë më tepër për mjedisin, për ngrohjen globale, për natyrën dhe për dashurinë për natyrën. Edhe në kohën e kësaj pandemie të tmerrshme një nga diskutimet më të mëdha është kërkesa drejtuar qenieve njerëzore për të bashkëjetuar me natyrën.

Efekti që po pëson liqeni i Prespës është realisht një nga shumë shenjat që Perëndia, nëse doni, jep për të kuptuar se dëshira për natyrën dhe mbrojtja e saj është një detyrë parësore. Po ashtu, pa dyshim është një privilegj për mua, si ministër i Turizmit dhe Mjedisit, në këtë rast të

ndaj me ju disa momente të zhvillimit të një nga zonave më të bukura historike dhe natyrore të vendit tonë, që është liqeni i Prespës, i cili lag brigjet e tri shteteve; lag jo vetëm tri shtete të ndryshme, por disa kultura dhe për të gjithë kohezionin që kërkohet sot në rajon është një nga ato pika që bashkon kaq shumë kultura, kaq shumë mentalitete, kaq shumë histori dhe është një nga monumentet natyrore të vërteta, për të cilat duhet të punojnë të gjithë së bashku që ta shndërrojmë në një burim të madh ekonomik.

Është e vërtetë edhe ajo që tha deputeti se jemi përpjekur dhe kemi realizuar një sërë aktivitete të rëndësishme në bashkëpunim me Bashkinë e Pustecit, në bashkëpunim me qarkun e Korçës për ta shndërruar liqenin e Prespës dhe Bashkinë e Pustecit në një destinacion të vërtetë turistik.

Janë jo pak, por vitin e kaluar 110 mijë turistë e kanë vizituar atë destinacion turistik dhe këta turistë pa dyshim që kanë ndikuar në zbutjen e varfërisë së kësaj zone. Pra, i nderuar koleg deputet, do të flasim më poshtë se çfarë kemi bërë ose çfarë po bën projekti, por thelbi i bisedës është biseda më e madhe që bëjmë për turizmin: sa industria e turizmit dhe industria e zhvillimit dhe mbrojtjes së natyrës do të ndikojë në ekonominë e familjeve shqiptare dhe sa do të ndikojë edhe në Bashkinë e Pustecit. Ju e dini shumë mirë, sepse kemi qenë së bashku në disa aktivitete, që tashmë janë disa bujtina dhe *guesthouse*-e, të cilat dy vjet më parë mungonin. Sot janë mbi 100 shtretër të deklaruar në atë bregliqen të vogël, ndërkohë që kërkesat janë për më shumë se kaq.

Ju e dini, i nderuar deputet, që tashmë Pusteci është një destinacion dhe në shumë ditë të vitit është e vështirë të gesh një dhomë të lirë apo një tavolinë për të ngrënë pa prenotim. Pra, zgjidhja nuk është vetëm një projekt, por ndryshimi i destinacionit. Sot Korça shënon një destinacion 12-mujor, falë investimeve që janë bërë në të gjithë infrastrukturën e zonës dhe investimeve që janë bërë në disa destinacione në Korçë, i cili për mua është më i miri, sepse jam partizan i asaj zone. Pra, është një destinacion për të gjithë dhe vajtja në Pustec është bërë një gjë krejt normale për çdo pushues që shkon në Korçë. Ky është ndryshimi që vjen nga zhvillimi turistik i zonës dhe nga ndryshimi i Shqipërisë.

Për sa i përket asaj që ndodh si pasojë e ngrohjes globale, ky nuk është vetëm një shqetësim shqiptar. Do të doja t'ju kujtoja, i nderuar deputet që në vendet e Bashkimit Europian, siç është Greqia, që laget nga ky liqen, molet dhe vendankorimet e barkave janë larguar 1000 metra nga uji, pasi uji është reduktuar dhe ata e kanë po aq shqetësim sa ne.

E njëjta situatë është edhe në Maqedoninë e Veriut. Pra, të tria shtetet së bashku e kanë shumë shqetësim nevojën për të kontribuar në ruajtjen e këtij liqeni, simbol i bashkëjetesës së tri kombeve tona, apo, nëse doni, edhe të kombësive që janë të përfshira në të, pasi ka më shumë se sa tri kombe të përfshira në liqenin e Prespës së Vogël. Pra, ngrohja globale dhe ngrohja me 2 gradë e temperaturës na bën që t'i vëmë gishtin kokës.

I nderuar deputet, në të paktën 3 vjet në këtë dikaster, kemi qenë së bashku në tri festa dimri të organizuara. Ju keni qenë dhe keni parë se si nga një festë në tjetrën nuk ka më borë, Perëndia nuk ka hedhur më borë në atë zonë, që më pas uji i borës të mbushë liqenin. Festa e dimrit këtë dimër, në dhjetor, ishte pothuajse me diell. Pra, ka ndryshuar klima, e cila ka sjellë edhe efektet e saj. Ky nuk është një problem vetëm rajonal, por botëror, që, siç e thashë, organizatat botërore dhe ndërkombëtare, në të cilat ne marrim pjesë gjithmonë e më shumë po e shikojnë me shqetësim.

Projekti për të cilin ju flisni vjen si pasojë e negociatave të qeverisë shqiptare dhe është një nga disa projekte, që në thelbi nuk kërkon të zgjidhë një detaj, sepse mbase do të ishte e kollajshme që të bënte një detaj, por kërkon të ndryshojë krejtësisht mentalitetin e funksionimit të atij territori dhe ka mbi vete atë që ju e sillni si shqetësim, që edhe unë e kam thënë publikisht dhe ju keni qenë prezent, komponentin e ekspertëve, komponentin e strategjive dhe komponentin e projekteve. Në fakt, në disa raste kjo është edhe filozofia e donatorëve, që të punojmë shumë më tepër për ngritjen e kapaciteteve, pasi një objekt i vetëm, që nuk mund të realizohet me vlerën e atij projekti, nuk vlen aq sa do të vlente ngritja e kapaciteteve në atë territor.

Unë kam shumë për të thënë për pyetjet tuaja, i nderuar deputet, por dua t'ju them se jeni i mirëpritur në zyrën time, në bashkëpunim të

hapur me stafin e Ministrisë së Mjedisit dhe me Agjencinë e Zonave të Mbrojtura. Ne mund të organizojmë një takim me komunitetin e zonës së Pustecit, por për interes të opinionit publik dhe kolegëve deputetë do të doja të përmendja disa nga ndërhyrjet që janë bërë atje, duke filluar që nga trashëgimia kulturore me rehabilitimin e kishës atje, rehabilitimin e disa objekteve të kultit, përgatitjen e strategjive për trajtimin e ujërave të zeza, për vaditjen, për vendgrumbullimin e mbetjeve urbane, për ndihmesën në trajtimin e vendgrumbullimeve të mbetjeve urbane për të gjithë qarkun e Korçës në landfillin e Maliqit (nuk do të doja ta bëja partner projektin, sepse projekti është një organizatë që funksionon në mënyrë independente), trajtimin e ujërave të zeza, ku është trajtuar paraprakisht plani i menaxhimit të ujërave të zeza në Pustec, realizimin e një industrie për tërheqjen e këtyre problematikave nga Pusteci, për kanalizimin e ujërave të zeza në bashkëpunim me AKUM-in për vlerësimin e impaktit në mjedis, pastaj për t'i dhënë mundësi qeverisë shqiptare që, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, të investojë në Pustec. Është bërë paraprakisht studimi për menaxhimin e mbetjeve urbane në Pustec; është lehtësuar procesi i komunikimeve të shoqërisë me menaxhimin e landfillit të Maliqit, siç ju thashë, projekti që kryen vlerësimin e kostos, tarifës, në Bashkinë e Pustecit. Do të rehabilitohet venddepozitimi i paligjshëm në Prespë për të hequr një gangrenë ambientale në atë zonë, projekti do t'i pajisë me adresaturat e nevojshme për këtë gjë. Po punohet për mbështetjen e banesave në park me eficiencën e energjisë, për transformimin e disa banesave në *guesthouse*, për trajnimin e personave të caktuar që do të punojnë në këtë industri dhe, natyrisht, ajo që është më e rëndësishme, transformimin e Pustecit në një destinacion turistik dhe pasuri kombëtare.

**Gramoz Ruçi** – Fjalën e ka deputeti Sterjovski. Keni shtatë minuta e gjysmë kohë, koleg deputet.

**Vasil Sterjovski** – I nderuar Ministër,

Duke qenë se liqeni i Prespës humbet çdo ditë sasi të mëdha uji, duhet të merren masa urgjente nga të tria shtetet, Shqipëria, Maqedonia, Greqia, pasi liqeni është në prag të një katastrofe mjedisore. Nga konsultimet që kam pasur me specialistë të fushës, si zgjidhje të

vetme për shpëtimin e liqenit të Prespës më kanë rekomanduar vënien përsëri në funksion të projektit të devijimit të lumit të Devollit.

Në vitin 1974 ka qenë një projekt nga qeveria komuniste për të transportuar ujërat e lumit Devoll në liqenin e Prespës së Vogël. Deri në vitin 2001 pjesa shqiptare e Prespës së Vogël furnizohej gjatë dimrit me ujë nga lumi Devoll, ndërsa në verë me këto ujëra vaditej fusha e Korçës. Në grykëderdhje ka pasur reduktorë për të ndaluar llumin që vinte nga lumi i Devollit.

Për shkak të menaxhimit të keq, pas viteve '90 kanali ushqyes dhe ai i komunikacionit, që lidhin lumin e Devollit me liqenin e Prespës së Vogël, nuk pastrohej dhe ujërat e turbullta të Devollit hynin pa ndaluar llumin dhe, me kalimin e viteve, në liqenin e Prespës së Vogël depërtuan 1,2 milionë metra kub sedimente, duke e kthyer pjesën shqiptare të liqenit të Prespës së Vogël në kënetë.

Për të vënë në funksion këtë projekt duhet një studim i mirëfilltë. Nevojitet një projekt i rehabilitimit të liqenit të Prespës së Vogël, pastrimi i kanalit ushqyes dhe atij të komunikacionit, si dhe të merren masa për të mos u futur llumrat e lumit të Devollit. Ky projekt mund të ketë një kosto të konsiderueshme, por, duke qenë si i vetmi opSION për të shpëtuar liqenin e Prespës, ky projekt mund të financohet së bashku nga të tria shtetet, Shqipëria, Maqedonia, Greqia, si dhe nga institucionet europiane dhe nga donatorë të tjerë.

Për sa u përket projekteve që janë zbatuar në parkun e Prespës, në bazë të ligjit për të drejtën e informimit, në shkurt dhe qershor të këtij viti nëpërmjet protokollit të Kuvendit i kam kërkuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit informacion se sa është fondi total i projekteve të ndryshme të donatorëve të huaj, si dhe të institucioneve vendase, që është investuar në Parkun Kombëtar të Prespës nga viti 1999 deri më sot. Deri sot Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk më ka kthyer asnjë përgjigje lidhur me këtë kërkesë, edhe pse, sipas ligjit, duhej të kisha marrë një përgjigje brenda dhjetë ditëve. Nuk e di pse është sekret shtetëror të dihen sa fonde janë dhënë për Parkun Kombëtar të Prespës në këta 20 vjet. Sipas të dhënave që mund të gjenden publikisht, për Parkun Kombëtar të Prespës në këta 20 vjet janë dhënë mbi 20 milionë euro nga donatorë të ndryshëm.

Nuk besoj se ka zonë tjetër në vendin tonë ku të jenë dhënë mbi 20 milionë euro, por, nga ana tjetër, banorët e kësaj zone të jenë më të varfrit në Shqipëri dhe ku papunësia të jetë mbi mesataren!

Të nderuar deputetë,

Është koha të flasim hapur për problematikat e menaxhimit të fondeve në Parkun Kombëtar të Prespës. Të gjitha këto projekte, që janë bërë në 20 vjetët e fundit për parkun e Prespës, janë shumë të mira në letra, por është shumë e vështirë të tregosh produktin që ka ardhur nga këto projekte, sepse nuk ka një investim që t'ua tregojmë banorëve. Organizohen vetëm seminare, trajnime, botohen strategji të ndryshme, thirren ekspertë të huaj. Nëse 20 milionë euro, që janë dhënë për zonën e Prespës, do të ishin shpenzuar në mënyrën e duhur, tani zona e Prespës do të ishte një nga zonat më të zhvilluara në vend.

Banorëve të zonës së Prespës u mungojnë disa kushte bazë jetësore, siç është furnizimi me ujë të pijshëm. Nga nëntë fshatrat e bashkisë vetëm dy fshatra e kanë zgjidhur problemin me ujin e pijshëm. E njëjta gjë është edhe për kanalizimet. Nuk ka mbështetje për zhvillimin e agroturizmit. Të gjithë këto projekte nuk kanë ndihmuar në përmirësimin e kushteve social-ekonomike dhe problemeve të shumta mjedisore, ku problemet me të mëdha janë ato të shkaktuara nga mbetjet urbane dhe derdhja e ujërave të zeza të papërpunuara në liqenin e Prespës.

Zoti Ministër, projekti aktual "Rezervuari ndërkufitar i biosferës Prespë", që po zbatohet me vlerën 3, 5 milionë euro, duhet të përfundojë në maj të vitit 2021, por banorët e komunitetit maqedonas që jetojnë në Bashkinë e Pustecit kanë humbur besimin në këtë projekt. Drejtuesit e këtij projekti së bashku me përfaqësuesit e parkut të Prespës formalisht organizojnë mbledhje me banorët, por nuk marrin parasysh kërkesat e banorëve. Nuk ka transparencë si shpenzohen fondet e këtij projekti. Banorët e Prespës, përveçse kanë humbur besimin në këtë projekt, janë edhe të indinjuar, sepse së fundi nga ky projekt janë shpërndarë disa grante 500-1000 euro sipas përkatësisë partiake.

Zoti Ministër, edhe ju vetë gjatë festimeve të 20-vjetorit për krijimin e Parkut Kombëtar të Prespës, në shkurt të këtij viti në Bashkinë e Pustecit publikisht shprehët zhgënjimin se ishte e

disata herë që vinit në Prespë dhe nuk kishit parë produkt të këtij projekti që t'u tregohet banorëve. Prandaj, kam një kërkesë për ju, zoti Ministër, përdorni autoritetin tuaj, por edhe kompetencat që ju jep ligji si ministër që të rishikoni projektin "Rezervuari ndërkufitar i biosferës, Prespë", në mënyrë që të kontrolloni si janë shpenzuar fondet e këtij projekti deri tani dhe pjesa që ka mbetur nga projekti të rinegocihet dhe të investohet në gjëra konkrete, që janë jetike për banorët e parkut të Prespës, siç janë furnizimi me ujë të pijshëm, kanalizimi i ujërave të bardha dhe të zeza, krijimi i kushteve më të mira për zhvillimin e agroturizmit, turizmit rural dhe familjar, sistemimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane e të tjera.

Për të ilustruar gjendjen në të cilën ndodhen banorët e komunitetit maqedonas në Bashkinë e Pustecit, po ju sjell një pjesë nga shkrimi i portalit "Korça report", që u botua disa muaj më parë. "Korça report" në këtë shkrim shkruan: "Nëse ka një zonë ku krerët e shtetit shqiptar dhe qeveria ndër vite kanë dhënë premtime pa fund kjo është në rajonin e Korçës, te zona e Pustecit. Nuk ka mbetur president dhe kryeministër pa deklaruar se në ish-komunën dhe tani Bashkinë e Pustecit do të investohet për turizëm dhe mirëqenie të banorëve. Me nëntë fshatra dhe me mbi pesë mijë banorë zona e Pustecit, e populluar thuajse tërësisht nga komuniteti dhe minoriteti maqedonas, vuan në këta 30 vjetët e fundit një prapambetje të madhe. Një investim i ndërmarrë nga qeveria gjermane për Parkun Kombëtar të Prespës, ku përfshihet Pusteci, nuk ka ndryshuar asgjë. Financimet me synim nxitjen e turizmit në zonë janë ndërprerë. Bashkia e Pustecit mund të tërheqë turistë me të kundërtën e saj: primitivizmin, jetesën e banorëve me shpirt nëpër dhëmbë, që provojnë mbi kurriz mungesat më elementare të një komuniteti në kohën e sotme. Këtu mund të shohësh se si toka lërohet ende me parmendë, gratë e moshuara që korrin nëpër kopshte me kosë, familje të tëra që sigurojnë jetesën me peshkim dhe nuk u gjendet një treg, por përndiqen nga policia kur shesin cironkat qosheve në rrugët e Korçës. Në Pustec nuk ka ujë të pijshëm dhe banorët i falen liqenit, ku shuajnë etjen dhe ku lajnë rrobat. Nuk ka një mjet për grumbullimin e mbetjeve urbane që t'i dërgojë ato në landfillin e Maliqit. Nuk ka mjet zjarfikës për shuarjen e zjarreve, por është

përshtatur një tip furgoni i vogël. Nuk ka farmaci, ku njerëzit të marrin ilaçet për problemet e shëndetit. Duket sikur Bashkia e Pustecit është e destinuar të vuajë një mijë e një halle. Këto ditët e fundit një përfaqësues i qeverisë vizitoi Pustecin dhe tha se zona do të bëhet modeli i turizmit, si urë bashkëpunimi dhe shenjë forcimi e miqësisë mes dy vendeve. Banorët, që kanë dëgjuar shumë nga këto premtime, e falënderuan sërish, por me zë të mekur, sepse ata i janë nënshtruar tashmë eksperimentit si minoritet", shkruan "Korça Report".

Të nderuar deputetë, ky është realiteti sot në Bashkinë e Pustecit. Varfëria në Bashkinë e Pustecit është në ekstrem, siç mund të shikoni edhe në këto dy foto. Banorët atje punojnë ende si në Mesjetë, ende sot punohet me mjete primitive. Banorët nuk kanë lekë të paguajnë traktorët për të lëruar tokat. Në Bashkinë e Pustecit bujqësia edhe sot në vitin 2020 ka mbetur në kushtet e një bujqësie për mbijetesë, pa mbështetje institucionale.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Zoti Ministër, keni disponibël një minutë e gjysmë.

**Blendi Klosi** – Me një minutë e gjysmë është e vështirë të japësh një përgjigje të plotë, por përsëri dua të falënderoj deputetin për ngritjen e shqetësimeve. Siç e përmendi edhe vetë, ka qenë prezent kur unë ngrita të njëjtat shqetësime që ngriti deputeti, pasi kërkesa për të bërë më të mirën është një kërkesë që bashkëjeton me qeverinë e Partisë Socialiste, me qeverinë e Edi Ramës. A kemi bërë më të mirën? Mbase jo, se ajo zonë ka shumë nevoja, por që Pusteci është transformuar, ju dhe unë të paktën, duhet të jemi të ndërgjegjshëm. Fakti që vetë Kryeministri ka qenë dhe të gjithë si qeveri kemi qenë dhe Pusteci është shndërruar në një destinacion turistik, është një përgjigje për pyetjet tuaja.

A është zhdukur varfëria në atë zonë? Unë mendoj, pa dyshim që jo, ka nevojë për t'u përmirësuar, ka nevojë për të ecur përpara, por të themi që jemi në rrugë të gabuar, nuk besoj se është një gjë e drejtë. A t'i kthehemi prapë asaj që thatë ju, pra investime për të shndërruar natyrën dhe për ta futur lumin e Devollit atje?! Është gabim dhe ekspertët thonë se është gabim. Ka ndodhur në vitet '60, është trajtuar si gabim,

se nuk zgjidh gjë, sjell sedimente në liqen dhe e zhduk liqenin fare. Pra, ata të cilët ju i quani ekspertët gjermanë edhe projekti i KfË-së, që po bëjnë shumë studime, mbase bëjnë më të mirën. Me 3 milionë euro që është ai projekt, mbase mund të ishte bërë një vepër publike, por ajo vepër e madhe publike që nuk zgjidhet dot as me 3 milionë euro, nuk vlen sa dija, sa eksperiencia, sa projektet dhe sa orientimi i drejtë i atij komuniteti. Pra, të jemi të sinqertë në gjërat që themi.

**Gramoz Ruçi** – Faleminderit, zoti Klosi!

Zoti Sterjovski, mund ta merrni fjalën, një minutë e gjysmë.

**Vasil Sterjovski** – Të nderuar deputetë, për Parkun Kombëtar të Prespës janë dhënë shuma të mëdha fondesh, për një menaxhim më të mirë mjedisor dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Pavarësisht të gjitha fondeve të dhëna deri më sot, vihet re që është arritur shumë pak në përmirësimin e kushteve të mjedisit natyror dhe nuk ka asnjë përmirësim të kushteve të jetesës së popullsisë lokale në Prespë. Keqmenaxhimi i fondeve financiare ka penguar për vite me radhë zhvillimin social-ekonomik të zonës së Prespës, si dhe marrjen e masave për krijimin e infrastrukturës bazë turistike.

Nuk mund të thuhet që në zonë nuk ka pasur ndryshime, por ato kanë qenë të pakta dhe të ngadalta. Kushtet ekonomike dhe mungesa e infrastrukturës janë problemet e para të cilat duhet të zgjidhen në zonë. Banorët e zonës janë njerëz përgjithësisht mikpritës, por për shkak të kushteve të vështira të jetesës shfaqin një qëndrim pesimist për të ardhmen e zonës së Prespës. Përgjatë viteve nuk ka munguar vëmendja e institucioneve të huaja për zonën e Prespës dhe as fondet e donacionet financiare të dhëna prej këtyre institucioneve, organizatave, por fondet nuk u menaxhuan siç duhej dhe në praktikë është bërë shumë pak. Këto fonde duhej të kishin shkuar për furnizimin me ujë të pijshëm, hapjen e kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza, për asfaltimin e rrugëve rurale, për furnizimin e rregullt me energji elektrike. Këto fonde kanë shkuar në hartimin e planeve dhe programeve pa fund, të cilat nuk u zbatuan kurrë.

**Gramoz Ruçi** – Faleminderit!

Këtu mbyllet interpelanca.

Vazhdojmë me projektligjin “Për aderimin në amendamentin DOHA të protokollit të Kiotos të konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike aderuar me ligjin nr. 9334, datë 16.12.2004”. Ministër i Turizmit dhe i Mjedisit, a dëshironi të merrni fjalën?

Fjala për ju, zoti Ministër.

**Blendi Klosi** – Projektligji vjen si një dakordësi e ekspertëve teknikë për përshtatjen e legjislacionit shqiptar në kuadër të kësaj konvente. Është pjesë e politikave që diskutuam edhe pak më parë me deputetin për të qenë pjesë integrale dhe pjesë aktive në diskutimet globale për mbrojtjen e mjedisit. Pa dyshim, është një nga detyrat e shumta që kemi në kuadër edhe të përafrimit të legjislacionit me Bashkimin Europian. Projektligji vjen i dakordësuar, besoj, me të gjitha grupet e interesit, si dhe me komisionet përkatëse të diskutimit në parlament, kështu që dua t’i falënderoj që kanë qenë të gjithë bashkëpunues dhe pozitivë në kudër të miratimit të këtij projektligji.

**Gramoz Ruçi** – Faleminderit!

Janë regjistruar për të debatuar për këtë projektligj, Taulant Balla, Vasilika Hysi, Andrea Marto, Besnik Baraj, Rudina Hajdari, Nimet Musaj, Enver Roshi, Andi Përmeti, Kostaq Papa.

Ju lutem, zoti Papa dhe zoti Gjuzi, e keni regjistruar dy herë emrin, do të flisni vetëm një herë.

Fjala për zotin Musaj. Zonja Hajdari, është prezent? Të përgatitet.

**Nimet Musaj** – Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë, do ta filloj sot me një urim për kolegen tonë, deputeten Evis Kushi, në detyrën e re si ministre e Arsimit. Suksese dhe mbarësi!

E kërkova fjalën për të vazhduar me rendin e ditës: rëndësinë e axhendës mjedisore. Pa shkëputur rëndësinë e koordinimit më shumë se njëpalësh për çështjet e mjedisit, rëndësinë e përballimit në grup dhe të përballjes në rrafsh ndërkombëtar me problematikat mjedisore, rëndësinë e aksionit të koordinuar global për çështje që duhen trajtuar edhe kombëtarisht, por që pa dimensionin e koordinimit global, dështimin e kanë të parashkruar, e mora fjalën për të dhënë disa mesazhe të tjera të rrafshit lokal. Për sa i takon aderimit të Shqipërisë në amendamentin DOHA, të protokollit të Kiotos, në krye të herës më duhet të deklaroj që e



mbështes pa rezerva këtë nismë. Ky nuk është një nga projektligjet e ndërlikuara. Nuk besoj se ndonjë nga palët ka mosdakordësi, por, edhe po të ishte ndër projektligjet e ndërlikuara apo ku palët teorikisht duhej të kishin mosdakordësi, personalisht, nuk do të më kompleksonte dhe qëndrimin tim nuk do t'i prekja asgjë. Nuk besoj që disa njerëz publikë të vënë lapsin mbi votat tona dhe duke i mbajtur shënim, t'ia nisin një poezie të dobët, të hershme: "Këta (bëhet fjalë për ne) votojnë të gjithë, siç voton apo siç kërkon qeveria", sepse, sipas tyre, opozitë do të thotë kundërshtim e jo partneritet; opozitë do të thotë kundërshtim për hir të kundërshtimit e jo rrugëtim; opozitë do të thotë bllokim e jo bashkëpunim; opozita do të thotë shmangie, ikje dhe jo përballje e propozim. Nuk besoj të ndodhë kështu, por edhe sikur të ndodhë, kjo nuk më komplekson. Shkolla politike, të nderuar kolegë, nuk bëhet, pasi dalin thinjat e para. Në këtë kuptim, unë jam ca i vonuar në moshë për ta kuptuar ndryshe nga sa e kuptoj opozitarizmin: dyer të hapura, partneritet, diskutim, propozim, bashkëpunim, korrektim e me radhë.

Për sa i takon projektligjit, po sqaroj me fjalë të thjeshta për publikun se ky projektligj që diskutojmë sot kërkon dhe përkon me nevojën për përshtatjen në rrafshin kombëtar të dinamikave globale, të përpjekjeve për mbrojtjen e mjedisit, duke reduktuar çlirimimin e gazeve të caktuara apo duke ndaluar të tjera, sipas disa amendimeve të bëra së fundi në nivel teknik. Kjo është më e pakta që mund të bëjmë ne, prandaj shkurtimisht jap mbështetjen time për këtë çështjeje.

Në anën tjetër, nga kjo foltore kam kërkuar që në muajin janar ose shkurt të vitit 2020, kohë kur përgatishim diskutimet e të enjteve të fundmuajit për çështjet e elektoratit zonal, ose siç quhej ndryshe "java e gjelbër", dhe gjej rastin të propozoj të rikthehet sa më parë si praktikë, t'i trajtojmë me kujdesin e një lloji tjetër, një herë e përgjithmonë, krimet mjedisore.

Asokohe ju tregoja se si zjarret nga maja e kodrave të Patosit zbritën një ditë aq pranë depozitave të naftës me ndihmën e rrymave të ajrit, sa që qyteti po mbante frymën i gjithi në ankth. Pak ditë më parë, në qarkun e Fierit kodrat e ullishtave përmbi Lushnjë, pylli fantastik i Semanit dhe i Darëzezës u gjendën nën flakë. Humbëm hektarë të tërë drurësh e

shkurresh. Dëmtuam mushkëritë e qytetit, në një kohë kur, simbolikisht, duhet ta them këtë, mushkëritë janë bërë kalaja që duhet për të mbrojtur trupat tanë nga kjo pandemi. Nuk di se çfarë do të nxjerrin hetimet si zanafillë të këtyre zjarreve. Me këto le të merren organet kompetente, por në mënyrë të veçantë, si deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në buxhetin e vitit 2021 unë do të propozoja dhe do të votoja pa rezerva dyfishimin, theksoj, dyfishimin e fondit për mjete dhe stafe zjarrfikësish. Ata burra të nderuar bëjnë maksimumin në luftë me flakët, por mbase ne nga këtu, nga kostumet tona, duhet të bëjmë më tepër për t'u gjendur atyre dhe mjedisit shqiptar në krah. Atje ka punonjës dhe drejtues të shkëlqyer e të përkushtuar. Sidomos në qarkun e Fierit, nga edhe vij, kam pasur nderin të ndaj orë të tëra diskutimesh me ta. Le ta rinovojmë, ta moderojmë dhe ta dyfishojmë brenda 1 viti të gjithë flotën zjarrfikëse të vendit; le të përfshijmë konceptin e 6-mujorëshit sezonal, ku të trajnohet dhe të merret me kontratë të jashtme staf shtesë në periudhat me probabilitet të lartë zjarresh: në muajt maj-shtator; le të kemi një hartë kombëtare, gjë të cilën e kam propozuar edhe më parë, të zonave me probabilitet të lartë zjarresh, pranë të cilave gjatë 6-mujorëshit emergjent të stacionojmë pika zjarrfikëseje të përkohshme. Këto ditë Priska dhe Sauku gjenden nën flakë. Unë i inkurajoj shërbimet zjarrfikëse t'i shuajnë ato dhe, pasi t'ia dalin, të ulen me specialistët e tyre më të mirë dhe të sjellin në Kuvend nevojat e tyre institucionale për vitin 2021. Po e deklaroj këtu para të gjithëve se kërkesat e tyre, edhe sikur ato të jenë të papërshtatura me realitetin, do t'i votoj symbyllur. Ata kërkojnë investime për rinovimin dhe zgjerimin e flotës zjarrfikëse. Unë i mbyll sytë dhe dua t'i përkrah me votë si deputet i këtij Kuvendi. Edhe sikur të keni vetëm votën time, llogariteni atë si paradhënie të këtij viti.

Në anën tjetër, duhet të ulemi bashkërisht dhe seriozisht që të bëjmë Kodin Penal, që është një gogol për këdo të cilit i shkon në mendje të hapë kullota përmes flakëve, por flakët e ligjit janë mbi flakët që hapin kullota.

Të nderuar deputetë, vetëm kështu do të ndizen më pak zjarre.

Për ta mbyllur, dua të prek edhe një çështje tjetër: axhendën e integritetit të vendit. Dje kam dëgjuar me kënaqësi të madhe dhe me optimizëm

raportimin që ministri i Jashtëm në detyrë, zoti Cakaj, bëri në Komisionin e Integritimit Europian. Nisur nga kjo, dua të ndaj me publikun disa konsiderata personale.

Konferenca e parë ndërqeveritare nuk do të jetë larg. Ne duhet të ndjekim me seriozitet çdo pikë të përfshirë në planin paraprak të veprimt. Për këtë kërkohet një klimë përkushtimi dhe komunikim i ndërsjellë midis të gjitha palëve të përfshira në proces. Disa prej përparësive të Këshillit të Europës janë tashmë pjesë e planit pesëmbëdhjetë pikësh që ministri e prezantoi dje. Jo të gjitha pikat lidhen me mbajtjen e konferencës së parë ndërqeveritare, por para kësaj konference, e cila ka vlerën e kryqëzimit të fundit të hyrjes në një proces me kaq rendësi, ne duhet të ushtrojmë të gjitha forcat dhe energjitë që kemi, që SPAK-u të vijojë punën me ritme të plota; reforma zgjedhore të ruajë njëtrajshmërinë dhe të vijojë nën klimën e bashkëpunimit rrugën drejt një procesi zgjedhor modern; Gjykata Kushtetuese, siç edhe Kryetari i Kuvendit, zoti Ruçi, e specifikoi me të drejtë në hapjen e këtij sesioni, duhet vënë në jetë dhe duhet të vijojë të jetë prioriteti ynë; Gjykata e Lartë duhet të formësohet përfundimisht dhe të gjejë rrjedhën normale të aktivitetit. Edhe pse në secilën prej këtyre pikave kërkohet kontributi i shumë aktorëve, jo të gjithë janë aktorë parlamentarë. Ne, në një linjë edhe me porosinë e miqve të Shqipërisë, ku veçoj specifikisht ambasadorin, Yuri Kim, nga ky institucion duhet të reflektojmë energjitë më pozitive të gatishmërisë për të dhënë kontributin për plotësimin e secilit prej objektivave që përshpejtojnë axhendën integruese.

Të nderuar kolegë,

Përshpejtimi i axhendës integruese duhet të jetë titulli, nëntitulli dhe kryeradha e çdo paragrafi të aktivitetit parlamentar të këtij sesioni.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Faleminderit!

Fjalën e ka Rudina Hajdari.

Të përgatitet Vasilika Hysi.

**Rudina Hajdari** – Teksa ne flasim për një marrëveshje që ka të bëjë me mjedisin, në fakt, dua t'ju tërheq vëmendjen për të folur për një grup naftëtarësh që sot janë pikërisht pranë Ministrisë së Energjisë. Ju e dini fare mirë që kjo nuk është një histori e re, por është e vjetër dhe i

përket një Shqipërie 30-vjeçare. Në fakt, është një histori e cila ka dy palë: në njërin anë kemi një palë, e cila ka punuar nga mëngjesi në darkë me djersën e vet për të mbajtur familjen, njerëz të palodhur, që nuk paguhen, nuk marrin pagat e tyre; nga ana tjetër, kemi disa njerëz, të cilët janë të pangopur, e kanë marrë këtë pasuri për vite me radhë e kanë shfrytëzuar dhe e kanë futur vendin në gropë. Dua të sjell në vëmendje këtu pikërisht naftëtarët e ndershëm të ARMO-s, sepse ata janë njerëz me dinjitet, por sot janë kthyer në njerëz pa dinjitet nga një qeveri dhe nga disa njerëz që janë të mbrojtur. Ata përballen me heshtjen e disa njerëzve këtu në parlament dhe të disa të tjerëve jashtë tij. Këta njerëz sot nuk gjejnë dot drejtësi, sepse deputetët heshtin, qeveria hesht, por edhe opozita jashtë parlamentit hesht përball këtij skandali me përmasë kombëtare.

U drejtohem atyre qytetarëve që sot më dëgjojnë se, para se të ndodhte privatizimit i ARMO-s, edhe pse ishte një korrupsion galopant, edhe pse kishte dy herë më shumë punëtorë në atë rafineri, ky lloj biznesi minimumi jo vetëm që i paguante punëtorët, por i jepte shtetit 12 mijë dollarë në vit dhe arrinte të paguante palët e treta. Pra, ishte në fitim, edhe duke qenë një biznes shumë i korruptuar. Pas privatizimit që ndodhi, qëkur ARMO u privatizua në kohën e Berishës, në kohën e PD-së, nuk ka ndryshuar absolutisht asgjë, dhe për këtë dua të jem transparente me publikun, pra edhe sot vazhdon të jetë një biznes i korruptuar që e ka çuar vendin në gropë. Pse do të thoni ju?! Sepse sot kemi 900 milionë dollarë borxh ndaj shtetit, ndaj palëve të treta dhe, çfarë është me e keqja, ndaj punëtorëve që sot janë pa rroga. Ata me të drejtë kërkojnë rrogat e tyre. Më thoni sot: a ka një procedim ndaj këtyre personave që e kanë çuar këtë biznes me 900 milionë dollarë borxh? Më thoni: a ka sot një procedim për ata njerëz që nuk i paguajnë këta punëtorë të thjeshtë?! Ka zero procedime! Por çfarë ka sot?! Ka naftëtarë në Shqipëri që me muaj, me vite, pra për një periudhë shumë të gjatë vazhdojnë të dalin nëpër rrugë për të protestuar. Modeli që sot kemi krijuar është: një grup të pangopurish, një grup qeveritarësh, të cilët heshtin përballë tyre, por sot janë të mbrojtur. Ndërsa ata naftëtarë që sot dalin nëpër rrugë, procedohen, sepse kërkojnë të drejtat e tyre: kërkojnë të paguhen për ato të drejta. Ky është modeli që ne kemi

ndërtuar sot në Shqipëri. Sot ne heshtim përballë atyre njerëzve të ndershëm që kërkojnë rrogat e tyre. Ky model duhet të shkërmoqet, sepse jemi përballë atyre njerëzve që sot jetojnë si sheikë; jetojnë nëpër vila të shtrenjta, ndërkohë që qytetarët nuk kanë një jetë dinjitoze dhe trajtohen si kriminelë....

*(Zonjës Hajdari i ndërpritet fjala, pasi i mbaroi koha në dispozicion.)*

**Gramoz Ruçi** – Faleminderit, zonja Hajdari!

Fjalën e ka Vasilika Hysi.

Të përgatitet Enver Roshi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë dhe kolege,

Ndryshimet klimatike përbëjnë një shqetësim global dhe problemet e shkaktuara nga veprimet e papërgjegjshme të njerëzve kërkojnë adresim nga të gjitha shtetet, nga parlamentet dhe nga ne si parlamentarë. Ndonëse ne jemi një vend i vogël dhe nuk emetojnë gazra të dëmshme, siç janë vendet e industrializuara, përsëri Shqipëria përballet me probleme që lidhen me mbrojtjen e mjedisit. Aderimi në konventën kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike në vitin 2004, protokollin e Kiotos, dhe projektligji i sotëm për votim për aderimin në amendamentin e DOHA-s janë shprehje të vullnetit politik të qeverive, sidomos të qeverive të majta, të cilat kanë aderuar në këto 3 dokumente të rëndësishme.

Protokollin e Kiotos kërkon reduktimin e gazit karbonik dhe reduktimin e të gjitha gazrave me efekt serrë. Ky amendament, që parashikohet të kalojë sot, ka vetëm një detyrim për shtetin shqiptar: adresimin e listës së re të gazrave me efekt serrë, e cila duhet të raportohet në institucionet përkatëse. Nga ana tjetër, duke mos pasur asnjë detyrim financiar pas aderimit në këtë amendament, sikurse është protokollin e Kiotos, unë do të kërkoja nga të gjithë ne, të nderuar kolegë, ta miratojmë këtë projektligj dhe t'i kërkojmë qeverisë, sidomos Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit që, sikurse raportojnë institucionet ndërkombëtare në lidhje me reduktimin e gazrave dhe masat që marrin institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, të raportojnë dhe t'i informojnë deputetët e Kuvendit të Shqipërisë në mënyrë sistematike dhe të kërkojnë nga ne çfarëdolloj mbështetjeje që duhet, sidomos për përmirësimet

ligjore apo për buxhetim më të mirë. Duke qenë se aderimi në këto amendamente kërkon ndryshime në ligjin për ndryshimet klimatike, ftoj ministrin përgjegjës t'i sjellë sa më parë ndryshimet në këtë ligj, njëkohësisht, inkurajoj fort edhe një buxhetim më të mirë për institucionet që merren me monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit.

Të nderuar kolegë, Shqipëria ka marrë një angazhim në kuadër të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Akhenda 2030) dhe objektivi 13 ka të bëjë me marrjen e masave për të luftuar ndryshimet klimaterike dhe efektin e tyre.

Sot ne jemi dëshmitarë të veprimeve të papërgjegjshme të njerëzve, të cilët në kushtet e thatësisë u kanë vënë flakën pyjeve më të bukura, kullotave. Kjo është pikërisht ajo pjesa e mushkërive të njerëzve, e oksigjenit, për të cilin sot më shumë se kurrë të gjithë qytetarët kanë nevojë. Të mos harrojmë që sot ne kemi vënë përballë forcat e emergjencës civile dhe bashkitë, të cilat, me të gjitha kapacitetet e tyre dhe me përkushtim, po luftojnë të vetme për ta përballuar këtë situatë. Kjo situatë nuk duhet të tolerohet më!

Ne, si parlamentarë, kemi tri përgjegjësi:

E para, të monitorojmë zbatimin e ligjeve.

E dyta, nëse ka nevojë për ndryshime në Kodin Penal, le t'i ashpësojmë dënimet për krimet mjedisore, sepse është qesharake që të djegësh një pyll të tërë, një vend që do qindra vite të bëhet, dhe të dënohesh me gjobë, që nuk kushton as sa një drekë e zakonshme në restorantin më të thjeshtë të një qyteti jo të kategorisë së parë.

Së dyti, sot dua t'u bëj një apel qytetarëve që të denoncojnë të gjithë abuzuesit dhe shkatërruesit e mjedisit, por të mos harrojmë edhe shumë biznese private, të cilat derdhin mbetjet në ujërat e shumë qyteteve të vendit, duke kontaminuar ujërat dhe pasuritë e qytetarëve.

Në fund të fjalës sime, dua të falënderoj të gjithë punonjësit e shërbimeve të zjarrfikësve dhe të emergjencës civile, të bashkive, të cilët, me përkushtim dhe me të gjitha vështirësitë që kanë, për shkak të mungesës së mjeteve moderne, siç i kanë shumë shtete të tjera, por edhe papërgjegjshmërisë, duke krijuar kaq shumë ndotje mjedisore dhe vënë zjarre në mënyrë të papërgjegjshme, i kemi vënë në një

situatë të vështirë. Inkurajoj fort dhe do të mbështes një buxhetim më të madh për zbatimin e ligjit shumë modern të emergjencave civile, për shtimin e burimeve njerëzore, për rritjen e trajnimeve të tyre dhe për një bashkëpunim shumë më të mirë. Gjithashtu, inkurajoj të gjithë kryetarët e bashkive që të vazhdojnë me mbrojtjen e pyjeve, mbjelljen e pemëve, shtimin e përdorimit të biçikletave, përdorimin e transportit publik dhe modernizimin e këtij transporti, me qëllim që të gjithë së bashku të kontribuojmë për mbrojtjen e mjedisit.

Ne këtu, në parlament, nuk duhet vetëm të aderohet, të ngremë dorën dhe të miratojmë akte ndërkombëtare, por, mbi të gjitha, duhet të kontribuojmë për zbatimin e tyre në praktikë.

Ndaj, të nderuar kolegë, ju ftoj ta miratojmë këtë projektligj dhe të gjithë së bashku, si përfaqësues të zgjedhur, të bëjmë më të mirën për një buxhetim më të mirë dhe për mbështetjen e këtyre forcave, që luftojnë përditë me papërgjegjshmërinë e njerëzve, bizneseve dhe ndonjëherë të përfaqësuesve të institucioneve.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** - Faleminderit, zonja Hysi!

Fjala për zotën Enver Roshi. Të përgatitet zoti Andrea Marto.

**Enver Roshi** - Të nderuar kolegë,

Meqenëse mjeku më rekomandoi të flas ulur, në respekt dhe mirënjohje për ju, duke filluar nga Kryetari dhe deri tek të gjithë deputetët e Kuvendit, për mbështetjen që më dhanë gjatë situatës shëndetësore kritike që kalova, do të ngrihem për të shprehur mirënjohjen dhe falënderimet e mia të thella për angazhimin që më dhatë, kurajën dhe motivimin për të jetuar!

Jam shumë i emocionuar, pasi kalova një situatë të rëndë shëndetësore.

Falënderoj mjekët, personelin shëndetësor, si dhe ata që janë në vijën e parë të luftës, të cilët janë shoqëruar edhe me humbje jetësh për të dhënë mbështetjen e tyre!

Me këtë rast i kërkoj qeverisë që “vështirësia e punës” për mjekët, e cila është hequr nga qeveria “Berisha” në vitin 2012, t’u rikthehet dhe ta marrin mjekët e Infektivit, të Sanatoriumit dhe të gjithë ata që rrezikojnë jetën e tyre pranë të sëmurëve.

Nga ana tjetër, dua t’u shpreh mirënjohje të gjithë qytetarëve të Shqipërisë, të Gramshit, Kukësit, Tiranës dhe kudo që ndodhen, të cilët, me mesazhet e tyre, më kanë inkurajuar për të jetuar e për t’u shërbyer atyre. Unë ju premtoj që do të jem një qytetar i denjë i gjithë Shqipërisë!

Kjo situatë e COVID-it ka të bëjë edhe me ndryshimet klimaterike, pasi ndryshimi i klimës dhe prishja e ekuilibrit të natyrës prej mijëra vjetësh cenon rëndë jetën e njerëzve në Shqipëri dhe kudo në botë.

Po kalojmë në stinën e virozave, ku bashkë me virozat është edhe COVID-i, sinergjizmi dhe prania e këtyre dy viruseve, si dhe qëndrimi në mjedise të mbyllura në stinën e dimrit e bën më emergjente situatën dhe qytetarët shqiptarë duhet të jenë të ndërgjegjshëm dhe të marrin përsipër fatet e shëndetit të tyre.

Është folur shumë për këtë situatë dhe politika duhet të jetë njëzëri në shërbim të qytetarëve. Qytetarët duhet t’i dëgjojnë këshillat mjekësore dhe të profesionistëve të tyre. Ka ikur koha që të merremi me fjalë, tani duhet vetëm punë. Ndërgjegjja kalon te qytetarët.

Nga ana tjetër, dua të shpreh mbështetjen time për protokollin e Kiotos. Ky ekuilibër natyror, i formuar prej miliona vjetësh, sot është në rrezik nga vetë njerëzit. Natyra shpiku gjithçka në larmishmërinë e vet, por shpiku edhe qenien më të ndërlikuar, më të bukur dhe më të vështirë, njeriun, të cilin duhet ta bindësh që të mos i vërë zjarrin natyrës. Thënia: “Think globally, act locally” nuk gjen vend në Shqipëri. Para 8-vjetësh, në malin e Priskës u rrit sasia e pluhurave dhe e hirit nën 2.5 mikronë 10 herë më shumë, e cila ka efekt kancerogjen dhe sot Priska është në zjarr. Këto zjarre nuk vihen pa dashje, por me qëllime të caktuara, armiqësore. Prerja e pyjeve, djegia e tyre dhe shkatërrimi i mjedisit përbëjnë terrorizëm dhe duhet të futen tek aktet terroriste, sepse të shkatërrosh pyjet dhe të prishësh gjithçka, që natyra ka krijuar prej miliona vjetësh, do të thotë t’i sjellësh një dëm kolosal shoqërisë, mjedisit dhe vendit ku jeton. Shqipëria për 100.000 banorë ka 39 vdekje në vit vetëm nga ndotja e mjedisit, pra nga ne, njerëzit, Homo Sapiens, qenia më e ndërlikuar, të cilët i vënë zjarrin pyllit me dashje, sepse vetëm me dashje vihet zjarri, nuk vihet gabimisht.

I bëj thirrje Shërbimit Informativ Kombëtar të mos rrijë të gjëmojë njerëzit, por të gjurmojë

këta keqbërës që i vënë zjarrin pyllit. Ku janë këta? Pse nuk kapen dhe dënohen? Të vihen dënime më të ashpra për ata dhe të kapen e të kalben në burg. Priska, pyjet e Kepit të Rodonit, të Mallakastrës dhe të Shkodrës kanë ditë të tëra që digjen. Shqipëria është në flakë. Nga 1 mijë zjarre në vitet e kaluara këtë vit ka 100 zjarre më pak dhe e quani krenari, por kjo nuk përbën një krenari, ky është një turp për ne shqiptarët në përgjithësi.

Qytetarë shqiptarë,

Mblidhni mendjen dhe shërbejini mjedisit tuaj, sepse ky mjedis do t'ju kërcënojë jetën tuaj sot, bijve tuaj dhe gjeneratave në të ardhmen!

Nuk kërcënohet Amerika nga zjarret në Shqipëri, por kërcënohet jeta e shqiptarëve këtu.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** - Fjala për zotin Andrea Marto. Të përgatitet zoti Andi Përmeti.

**Andrea Marto** – I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Qëllimi i këtij projektligji është aderimi i Shqipërisë në amendamentin DOHA, i cili vjen si detyrim pas aderimit të Republikës së Shqipërisë në protokollin e Kiotos me ligjin nr. 9334, datë 16.12.2004.

Protokollin e Kiotos është kompromisi që u arrit në Kioto të Japonisë në muajin dhjetor të vitit 1997, për reduktimin e emetimit që shkaktojnë gazrat me efekt serrë. Në Kioto 38 vende të industrializuara ranë dakord, në një marrëveshje detyruese, që në vitin 2012 të reduktonin emetimin e gazrave me efekt serrë në nivelet e vitit 1990.

Qëllimi i protokollit të Kiotos është vendosja e kufijve në sasinë e CO2-it, që mund të emetojë çdo vend. Protokollin synon të nxisë bashkëpunimin me shtetet e tjera palë për të rritur efektivitetin individual dhe për të kombinuar politikat dhe masat e miratuara.

Amendamenti DOHA i protokollit të Kiotos, të cilin do ta miratojmë sot, përmban 3 detyrime për palët:

E para, angazhime të reja për palët në aneksin I të protokollit të Kiotos, të cilët kanë rënë dakord për një periudhë të dytë angazhimi, nga 1 janari 2013 deri më 31 dhjetor 2020. Për vendin tonë kjo nuk sjell ndryshime, pasi vendi ynë nuk është në vendet e zhvilluara, që emetojnë sasi të mëdha gazrash me efekt serrë, prandaj ai nuk ka efekte financiare.

E dyta, një listë e rishikuar e gazeve me efekt serrë do të raportohet nga palët në periudhën e dytë të angazhimit. Kjo pikë është konsideruar gjatë përgatitjes së draftit që kemi në Kuvend për ndryshimet klimatike. Aneksi i këtij projektligji përshkruan listën e gazrave me efekt serrë sipas ndryshimit DOHA. Për këtë arsye dhe për faktin që Shqipëria ka ratifikuar marrëveshjen e Parisit, efektivisht ajo është pozicionuar në mbështetje të këtij amendimi, ku pranimi dhe miratimi i tij sot janë thjesht një formalitet.

E treta, ndryshimet në disa nene të protokollit të Kiotos, që specifikisht shqyrtojnë çështjet, të cilat kanë të bëjnë me periudhat e angazhimit të marrë duhet të përditësohen në periudhën e dytë të angazhimit. Edhe kjo pikë nuk sjell detyrime financiare, sepse bën pjesë në aneksin e parë të Konventës së Kiotos.

Aktualisht, amendamenti DOHA i protokollit të Kiotos është miratuar nga 130 shtete në botë. Ratifikimi i amendamentit DOHA të protokollit të Kiotos nuk do të sjellë detyrime apo kosto financiare shtesë për Republikën e Shqipërisë. Edhe kjo, ashtu siç thamë, nuk bën pjesë në aneksin II të konventës dhe as në aneksin B të protokollit të Kiotos, ku bëjnë pjesë vendet me detyrime për reduktimin e shkarkimeve të gazrave me efekt serrë.

Nëpërmjet këtij aderimi në amendamentin DOHA Shqipëria tregon që është një vend, i cili zbaton me seriozitet detyrimet e saj, është një vend që merr përsipër dhe angazhohet për zvogëlimin e emetimeve të shkaktuara nga ne të gazrave me efekt serrë dhe për këtë Kuvendi është duke punuar me dy ligje të rëndësishme, siç është ligji për ndryshimet klimatike dhe ligji për rritjen e konsumit të biokarbutanteve në transport, të cilat po diskutohen në komisionet parlamentare.

Për sa më sipër, i ftoj të gjithë kolegët që njëzëri ta miratojmë këtë projektligj!

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** - Faleminderit, zoti Marto!

Fjala për zotin Përmeti. Të përgatitet zoti Besnik Baraj.

**Andi Përmeti** - Gjatë këtyre ditëve kam dëgjuar shumë kolegë, deputetë të Partisë Socialiste, të flasin për fushatë, ndryshime në qeveri dhe për pritshmëritë e tyre, por askush, as zonjat, nuk ka guxuar të flasë për kërcënimet

publike që Sandër Lleshaj i ka bërë gazetarit Elvi Fundo. Askush, as Elisa, e cila qahej nga kjo follore që po shpifnin për të dhe familjen e saj, nuk ka guxuar të thotë një fjali për kërcënimin publik që Sandër Lleshaj i ka bërë gazetarit.

Sandër Lleshaj është personi përgjegjës që duhet të zgjidhë atentatin që iu bë gazetarit në mes të Tiranës. Ai jo vetëm fle mbi atë dosje dhe shumë të tjera, por guxon dhe kërcënon publikisht. Për çfarë? Çfarë është thënë nga gazetari? Janë bërë disa pyetje publike shumë të thjeshta.

Zoti Ministër, sa është blerë makina me të cilën qarkulloni nëpër Tiranë, që është makinë e blerë me lekët e taksapaguesve shqiptarë? A është zhdoganuar ajo makinë kur ka hyrë në territorin shqiptar? Targat me të cilat qarkullon ajo makinë, janë të targuara apo false? A ka siguracion makina me të cilën qarkulloni ju, apo jo?

Këto janë pyetjet që ka bërë media.

Do të ishte shumë e thjeshtë, zoti Ministër, që ju të nxirrni dokumentet dhe ky muhabet të mbyllej njëherë e mirë, por ju jo vetëm keni zgjedhur të mos nxirrni asnjë dokument publik, por keni zgjedhur të kërcënoni një medie duke i thënë lloj-lloj epitimesh.

Unë nuk ndiej keqardhje për ju, se po të ishte për ju, mbase mund ta godisnit edhe me gaz lotsjellës medien, nuk do ta kishit problem, por ndiej keqardhje për të gjithë këta kolegë këtu, të cilët kanë dalë e kanë folur edhe për ligjin antishpifje, kanë folur edhe për lirinë e medias dhe kanë treguar qartazi se çfarë qasjeje kanë për të mbrojtur medien e lirë, kur ajo cenohet publikisht nga njeriu, i cili në këtë follore gjithmonë ka thënë vetëm një shprehje për çdo akuzë që i është ngritur: “Ju shpifni. Kur keni prova, shkoni në gjykatë!”

Shkoni në gjykatë, zoti Ministër, mos shpifni në *Facebook*!

**Gramoz Ruçi** – Zoti Përmeti, abuzuat me të drejtën e fjalës. Keni një ligj të caktuar. Është në të drejtën tuaj që, nëse keni probleme me një ministër, ta thërrisni në interpelancë dhe t'i trajtoni të gjitha çështjet që ngritët, por jo kështu.

Mos e përsërisni herë tjetër, se do t'juja ndërpres menjëherë fjalën!

Urdhëroni, zoti Lleshaj!

**Sandër Lleshaj** – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Zoti deputet,

Bëni mirë që bëheni zëdhënësi i një personi të caktuar, që ju e quani “media”, unë nuk e di se kush është. Nuk i kam kthyer përgjigje të ashtuquajturës “media”, që ju përmendni, për arsye se nuk e konsideroj të denjë për t'i kthyer përgjigje.

*(Ndërrhyrje nga salla.)*

Juve ju kthej përgjigje. Ju thatë diçka të bukur në fund, që në vend t'i turrem medias, të shkoj në gjykatë. Në gjykatë shkon ai që ka një problem. Në qoftë se ju keni një problem me ministrin e Brendshëm, duhet të shkoni ju në gjykatë.

*(Deputeti Përmeti ndërhyr nga vendi.)*

**Gramoz Ruçi** – Mos flisni nga vendi, ju lutem!

**Sandër Lleshaj** - Unë nuk kam probleme me medien.

Media, të cilës ju i referoheni, nuk e meriton emrin ose ndajshkrimin “media” për sa kohë është një instrument mashtrimi publik.

*(Deputeti Përmeti ndërhyr nga vendi.)*

Këtë fakt e di unë. Unë e kam të qartë faktin se media së cilës ju i referoheni ka bërë një mashtrim publik, për të cilin insiston në mënyrë kriminale prej disa ditësh. Prej disa ditësh kjo media mashtron në mënyrë skandaloze publikun, duke thënë se Sandër Lleshaj ka blerë automjet. Unë kam një automjet Honda të vitit 2010, si Sandër Lleshaj. Kjo media nuk ka asnjë tagër të gjurmë nga prapa automjetet që përdor ministri i Brendshëm, të cilat nuk janë vetëm një, por janë disa.

Dua t'ju them juve dhe publikut: kjo media ka pasqyruar një fakt të rremë skandaloz, ku thuhet se është blerë një automjet me vlerë 100 milionë lekë, ndërkohë që është pasuar nga një media tjetër më e ndyrë se kjo, që thotë se është 150 mijë euro.

Po ju them me përgjegjësi të plotë se mjeti i blerë për llogari të Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë nuk ka kushtuar 150 mijë euro, nuk ka kushtuar 100 milionë, por ka kushtuar vetëm 49 mijë euro...

*(Deputeti Përmeti ndërhyr nga vendi.)*

Hajde blije ti!

*(Deputeti Përmeti ndërhyr nga vendi.)*

Ju sfidoj! Në qoftë ai mjet nuk ka kushtuar 49 mijë euro, unë jap dorëheqjen këtu. Në qoftë

se kushtuar 100 milionë, atëherë jepni dorëheqjen ju, megjithëse ju e keni të dhënë dorëheqjen.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Faleminderit, zoti Lleshaj!

Urdhëroni, zonja Spiropali!

**Elisa Spiropali** – Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Përmeti, nuk e kuptoj pse këtu zgjodhët të bënit zëdhënësin e portaleve të medieeve, sepse duhet ta dini që unë, në këtë foltore, kam reaguar për ata që ju kanë quajtur “delenxhinj”.

*(Deputeti Përmeti ndërhyh nga vendi.)*

Jo, jo, ule zërin tani, se do të flas unë!

Ata që ju kanë quajtur, pa pikë etike gazetareske, “delenxhinj”, ju kanë quajtur “sharlatanë”, ju kanë quajtur “shërbëtorë të krimi”, “injanantë të pashoq”, “kërpërata” e të tjera.

Unë nuk e di, por në rast se ju të tilla kanale dhe portale që përdorin këtë gjuhë, guxojnë të fyejnë parlamentin e Shqipërisë, institucionet e shtetit shqiptar, nuk kanë asnjë kujdes për gjuhën dhe për të vërtetën, i quani “media të lira”, atëherë është e drejta juaj, por, ju lutem, ruani dinjitetin tuaj dhe mbani qëndrim si kur sulmoheni ju me bojë në media dhe në fyturë, ashtu edhe kur sulmohen kolegët tuaj këtu, ministra apo deputetë qofshin.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Urdhëroni, zoti Baraj!

**Besnik Baraj** - Faleminderit!

Unë nuk do të përsëris një sërë përshkrimesh që u bënë këtu më parë, veçanërisht nga deputeti Marto, i cili mjaft qartë përshkroi protokollin e Kiotos, njëkohësisht edhe amendimet e DOHA-s, si dhe efektet që kanë për vendin tonë.

Unë do të shtoja si informacion se Shqipëria ka aderuar në protokollin e Kiotos në vitin 2004 dhe janë gjashtë komponime kimike që janë vlerësuar se kanë efekt serrë. Madje, për nga sasia, është dioksidi i karbonit ai që ka vlerën më të madhe që emetohet, për shkak të veprimtarisë antropogjenike, por ka gaze të tjerë me efekt shumë më të madh se sa dioksidi i karbonit, siç është edhe vetë metani. Ka edhe gazra të tjera, si komponimet e fluoruara të hidrokarbureve, të cilat kanë një efekt jashtëzakonisht të lartë serrë dhe njëkohësisht

luajnë rol edhe në shkatërrimin e shtresës së ozonit.

E veçantë është se SHBA-të nuk e kanë firmosur këtë, ndërsa Kanadaja në vitin 2012, praktikisht, është larguar nga protokollin e Kiotos.

Sigurisht, mosnënshkrimi i SHBA-ve ka një efekt shumë të madh, sepse ata janë edhe kontribuesit parësorë të gazeve me efekt serrë në nivel global.

Interesant është fakti që kriza e vitit 2008, njëkohësisht edhe pandemia, që jemi duke kaluar, kanë çuar në zvogëlimin sinjifikativ të gazeve me efekt serrë për shkak të kufizimit të veprimtarisë prodhuese.

Shqipëria është një vend modest, me kapacitete modeste industriale, pa dyshim edhe në nivel global roli kontaminues i Shqipërisë është shumë i vogël, megjithatë, siç e tha edhe parafolësi, doktori, që të mendojmë globalisht dhe të veprojmë lokalisht, edhe ne kemi përgjegjësitë dhe detyrimet tona, me qëllim që të kontribuojmë modestish në uljen e këtyre.

Kolegët përmendën zjarret që ndizen në Shqipëri dhe, pa dyshim, kërkojnë që jo vetëm të forcohet ligji për t'i penalizuar zjarrvënësit, por njëkohësisht edhe për të rritur kapacitetet e zjarrfikësve në nivelin e duhur, me qëllim që t'i kufizojmë sa më shumë.

Një faktor tjetër që emeton gaze serrë, përfshirë dyoksidin e karbonit dhe metanin, për shkak të dekompozimit të produkteve që depozitohen, janë venddepozitimet e mbetjeve urbane. Është për të të ardhur keq, që, megjithëse kemi disa qytete, ku janë bërë landfillet me standarde, ka qytete në të cilat ende sot e kësaj dite vazhdojnë të digjen mbetjet nga njerëz të papërgjegjshëm. Ky është një problem i madh, sepse jo vetëm që emetohen gaze me efekt serrë, por emetohen njëkohësisht edhe substanca shumë toksike, të cilat në nivele shumë të ulëta kanë një efekt të rëndë për shëndetin e njeriut, sikurse janë dioksinat.

Nga ana tjetër, unë do të thosha se do të ishte mirë, meqenëse është edhe një tendencë edhe në nivel rajonal, siç është TEC-i i Vlorës, i cili ka treguar se është një investim i gabuar dhe i dështuar, por që ka plane për konvertimin e tij me gaz, që kjo të realizohet dhe nëse një ditë TEC-i do të punojë, të punojë me gaz, meqenëse edhe misioni i substancave me efekt serrë është

sa gjysma e atyre me qymyr apo me hidrokarbure.

Së fundi, do të thosha se duhet inkurajuar ajo që tashmë ka nisur në qeverinë tonë, burimet alternative të energjisë, veçanërisht ato solare. Ne jemi me fat që kemi rrezatim diellor pothuajse maksimal për rajonin dhe zhvillimi i kësaj teknologjie dhe marrjes së energjisë prej këtyre burimeve është shumë i rëndësishëm. Kujtoj këtu se Gjermania rreth 40% të energjisë për nevojat e vendit e siguron nga energjia e rinovueshme, që është kryesisht solare dhe eolike.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Urdhëroni, zoti Balla!

**Taulant Balla** – Faleminderit, Kryetar!

Pa dyshim që kolegu Baraj ishte shterues në aspektet që sjell amendamenti i DOHA-s në protokollin e Kiotos, të cilat lidhen me çështje shumë të rëndësishme të mjedisit. Edhe unë i bashkohem shqetësimit që përcollën shumë kolegë për nivelin dhe numrin e shtuar të zjarreve, që, në dyshimet e shprehura nga kolegët, por edhe në atë që media ka transmetuar, në shumë raste janë të qëllimshme. Edhe pse Kuvendi i Shqipërisë gjatë viteve të fundit, në ndryshimet që ka bërë në Kodin Penal, e ka ashpërsuar nivelin e dënimit ndaj zjarrvënës së qëllimshme, jemi përsëri në një situatë tejet të vështirë, pasi në zona me shumë rëndësi për sa i përket mjedisit, madje edhe pranë banesave, si, për shembull, dje në Elbasan kemi pasur një rast të përsëritur në mushkërinë e qytetit të Elbasanit, sikurse është Kodër-Krasta, ku në mënyrë të qëllimshme herë pas here zjarret vendosen nga njerëz të papërgjegjshëm, duke dëmtuar kurorën e gjelbër të qytetit.

I bashkohem thirrjes që bëri zoti Roshi, duke e uruar për shërimin, pas përballjes me COVID-in, që jo vetëm institucionet brenda Policisë së Shtetit, por edhe Shërbimi Informativ Shtetëror, detyrimisht, duhet të marrë përgjegjësitë që i takojnë në lidhje me identifikimin e gjithë këtyre personave.

Jam i bindur se portali i Shkëlzen Berishës, *Syri.net* apo i dhëndrit të Sali Berishës, “*Jeta është pa qejf*”, do të kenë shumë arsye për të prodhuar lajme sot. Edhe pse nuk lidhet me këtë temë, por meqenëse këtu u prek çështja e medias, Shqipëria domosdoshmërisht duhet të hedhë një hap të rëndësishëm për transparencën e pronësisë

së medias. Çdo medie duhet ta ketë të publikuar zyrtarisht se cila është pronësia, cilët janë gazetarët që shkruajnë me emra *fake* ose prodhojnë lajme *fake*, pastaj, si pasojë e kësaj.

Në lidhje me dy mediet që përmenda më lart, mjafton të bësh një pyetje: si financohet televizioni i djalit të Sali Berishës, apo si financohet portali “*Jeta është pa qejf*”, e kupton qartë se si fabrikohen lloj-lloj mediesh dhe lloj-lloj lajmesh në Shqipëri.

Meqenëse këtu pati një shkëmbim replikash, do ta quaja, do t’u thosha deputetëve të opozitës, duke qenë se edhe vetë kam qenë në opozitë: përpara se të ngrini gishtin e akuzës në lidhje me një lajm që vjen nga një medie e caktuar, bëni mirë që t’i drejtoheni zyrtarisht ligjit “Për statusin e deputetit”, i cili ka të përcaktuar qartë mënyrën se si mund ta marrë informacionin një deputet, si dhe detyrimin që ka institucioni për t’u përgjigjur brenda një afati shumë të ngushtë kohor.

Pra, nëse doni informacion për makinën me të cilën lëviz ministri i Brendshëm apo çdo zyrtar i këtij shteti, shkruani dy gisht letër, bazuar në ligjin “Për statusin e deputetit”, dërgojeni atë sipas procedurës parlamentare, dhe të jeni të sigurt se do të merrni përgjigje.

Koha kur në këtë Kuvend nuk kthehej përgjigje ka marrë fund me Saliun dhe Jozefina Topallin. Atëherë po, nuk lejohej t’u kthehej përgjigje deputetëve të opozitës. Ishte urdhër i prerë i zonjës Topalli, që opozitës të mos i kthehej përgjigje. Ndërkohë që Gramoz Ruçi është në krye të Kuvendit, nuk ka ndodhur një herë që t’i heqë opozitës asnjë prej të drejtave që i takojnë me ligj. Prandaj, drejtohuni me shkrim dhe merrni përgjigje.

Ndërkohë, qoftë ju, qoftë zoti Valteri, keni mundësinë që më pas të kërkonit edhe falje për akuzën që mund të keni ngritur me të padrejtë, gjë që ju nderon.

(Debat në sallë)

Ju lutem!

Tani, ajo që po thosha: ju jeni të ndryshëm nga kasandrat e opozitës rrugore, ndaj ruajeni ndryshueshmërinë me to deri në fund. Meqenëse u përmend media apo gazetari në fjalë, ai gazetari është dhunuar vite më parë, është goditur rëndë. Unë kam qenë një nga ata persona publikë që kam shprehur dënesën, i kam kërkuar hetim ministrit të Brendshëm të asaj kohe. Dua të them



se jam i gatshëm, nëse prokuroria dhe policia e bëjnë punën si duhet, të jap edhe informacione që vlejné, sepse pas atij sulmi ndaj gazetarit Elvi Fundo, sipas dyshimeve të qenësishme, fshihej Lulzim Basha, kryetari i partisë tënde, të paktën deri kur erdhe në parlament, si dhe i partisë së Halit Valterit.

*(Debat në sallë)*

Dakord! E keni pasur Lulin kur erdhët në parlament, e kishit kryetar derisa erdhët në parlament. Me firmën e Lulit keni ardhur të dy.

Meqenëse ju mund të kontribuoni, meqenëse ju dhimbset shumë cenimi i lirisë së medias nga ana e ministrit të Brendshëm, i cili nuk ka bërë ndonjë herezi të madhe, por thjesht ka refuzuar me të drejtë disa informacione të padrejta, drejtohuni me shkrim dhe merrni përgjigje.

Meqenëse e mora fjalën, përsëri do të flas për një lajm të rremë që hodhi zonja Hajdari lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me rafinerinë e Ballshit, përpara se të ngrini gishtin e akuzës ndaj kësaj qeverie dhe ndaj kësaj maxhorance, duhet të shikoni arsyet që e kanë çuar rafinerinë e Ballshit në atë situatë. Rafinerinë e Ballshit e ka çuar në atë situatë një privatizim korruptiv, i paligjshëm i Sali Berishës.

Ju keni të drejtë, sepse ai privatizim duhej të denoncohej dhe të hetohej që në vitin 2013 nga prokuroria. Pa dyshim, nuk ka pasur ndonjëri pritshmëri që prokuroria e 2013-ës, e 2015-ës, e 2016-ës dhe deri tani që kemi funksionale Prokurorinë Speciale Antikorrupsion nuk do të bënte ndonjë hetim. Nëse do të hapej një hetim për atë çështje, e cila është një ndër shumë çështjet që duhen rihapur hetimi, sikurse duhet rihapur hetimi edhe për masakrën e "Gërdecit", pas konfirmimit nga drejtësia amerikane se Shkëlzen Berisha është një prej personave të përfshirë në atë fatkeqësi, në atë akt korruptiv, në atë krim shtetëror; përpara se të ngrini akuzën mbi ministrat e kësaj qeverie, të paktën keni detyrimin të shikoni dhe të bëni një hulumtim të çështjeve dhe arsyeve që e kanë çuar në atë situatë të vështirë kompaninë "ARMO", që nuk është një kompani shtetërore. Unë nuk di se si mund të ngresh gishtin kundër qeverisë apo kundër institucioneve të tjera shtetërore, kur pa dyshim ajo është një kompani private. Është një kompani private, është një shkëmbim mes privatësh, në përpjekjen për ta

rivendosur në punë, por zanafilla e gjithë kësaj historie lidhet me privatizimin.

Në fund të fjalës time, meqenëse është edhe seanca e parë e punës së këtij sesiioni të parafundit të kësaj legjislatore, gjej rastin t'i nxis pesë anëtarët e komisionit të posaçëm të përzgjedhjes së anëtarëve të rinj, të strukturës së re të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që këtë punë ta bëjnë në mënyrë të menjëhershme. Besoj se afati i vendosur 60 ditë, nga dita e emërimit brenda 30 ditëve, është shumë i mjaftueshëm, ndaj nuk ka pse ta ezaurojë gjithë këtë afat. Ta bëjmë procesin e përzgjedhjes brenda pak ditëve dhe një seancë sa më të afërt të Kuvendit, sipas asaj që ka përcaktuar, por, edhe sipas marrëveshjes së 5 qershorit, të kemi mundësi të zgjedhim edhe komisionerin, edhe anëtarët e dy institucioneve të tjera të KQZ-së, me qëllim që fillojë menjëherë implementimi i parashikimeve në Kod, të vendosura edhe për pasojë të 5 qershorit, ku zbatimi i teknologjisë në identifikimin e zgjedhësve është i një rëndësie parësore. Ndërkohë, ne si Kuvend i Shqipërisë duhet të punojmë në lidhje me një detyrë tjetër, të vendosur edhe nga Bundestagu gjerman, edhe nga mbledhja Këshillit Europian në muajin mars, ku na kërkohet rritja e transparencës së financimit të partive politike.

Nuk duhet të humbim kohë. Komisioni i Ligjeve duhet të marrë përgjegjësitë që i takojnë, në bashkëpunim me komisionet e tjera, por edhe me partitë politike. Në vitin 2021 duhet të kemi gati një ligj, i cili garanton transparencën e plotë të financimit të partive politike. Nuk mund të tolerohet më, si në rastin e vitit 2017, kur një parti politike shqiptare harxhoi rreth 1 milion dollarë. E dini kujt i referohem: u referohem pagesave të dyshimta të Lulzim Bashës kundrejt kompanive të lobingut në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të paguar baltën që duhej hedhur mbi Shqipërinë dhe proceset e saj integruese.

Këto lloj financimesh të partive politike duhen penguar, sepse janë financime të paligjshme, janë financime të padeklaruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, janë të pakontabilizuara në të ardhurat e Partisë Demokratike. Ka edhe raste të tjera. Parti të reja politike po lindin. Edhe ndaj tyre duhet ushtruar procesi i kontrollit të financimit, me qëllim që çdo parti politike të ketë një pasqyrë financiare shumë të qartë para shqiptarëve.

Ne nuk duhet të humbim kohë. Është një prej detyrave të lëna nga Bundestagu dhe nga mbledhja e Këshillit European në muajin mars. Në mënyrë urgjente duhet ta kemi gati. Është bërë një punë e shkëlqyer, në bashkëpunim me Këshillin e Europës, që prej kohës kur unë kam drejtuar Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore, dhe janë identifikuar mekanizmat se si mund të garantohet një financim i ndershëm i partive politike.

Gjithashtu, meqenëse kam edhe pak minuta kohë, dua që bashkëpunimin që kemi pasur me opozitën parlamentare në lidhje me çështje të rëndësishme, sikurse është implementimi i plotë i reformës në drejtësi duhet ta përmbyllim në kohë edhe ligjin për Presidentin e Republikës. E përgëzoj Komisionin e Çështjeve Ligjore në Kuvendin e Shqipërisë, që ka ngritur një grup pune, në të cilin përfaqësohet edhe maxhoranca, edhe opozita. Është i domosdoshëm kornizimi i aktivitetit të Presidentit të Republikës nëpërmjet një ligji të posaçëm. Ne kemi ligj për çdo institucion, dhe kemi njëzet e kusur vjet me Kushtetutë të re, pas miratimit të saj nga vetë populli, me referendum, por nuk kemi bërë ende një ligj për Presidentin.

Ligji për Presidentin është i domosdoshëm, sepse së fundi Presidenti aktual i Republikës ka treguar raste të përsëritura të përplasjes e të shkeljes së ligjit dhe të Kushtetutës, duke abuzuar me faktin e mospasjes së një ligji për Presidentin.

Shumë faleminderit!

*(Ndërhyrje nga salla.)*

**Gramoz Ruçi** – Zoti Përmeti, uluni!

Zotit Valteri i është përmendur emri.

**Halit Valteri** – Të nderuar kolegë,

I nderuar zoti Balla,

Nuk më shqetëson aspak personi në fjalë, gazetari Fundo, sepse vetë kam qenë pre e asaj medie, por tek e fundit është medie. Nëse ministri i Brendshëm e quan një medie “kriminale”, atëherë çfarë pret, kur për të luftuar krimin është aty?! Shko, hetoje dhe çoje para drejtësisë!

Për sa i përket makinës, unë dhe të gjithë shqiptarët nuk jemi fare të surprizuar, sepse kemi parë që uniformat e Policisë së Shtetit janë bërë me tenderë, sikur blihen tek “Armani”! Sikur blejnë një xhup 300 dollarë tek “Armani” dhe jo një uniformë të Policisë së Shtetit të qepur në

rrobaqepësi! Kemi parë që zyrtarët e policisë të zotit Lleshi nuk e pyesin fare për këtë gjë. Madje, e inkurajoj Ardi Velion ta thërrasë në punë këtë zotërinë, sepse, në dijeninë time, nuk i hap as telefonin. Kurse për makinën që keni, e keni detyrim moral dhe përgjegjësi para shqiptarëve, sepse ministri i Brendshëm nuk mund të lëvizë si gangster me targa të makinave operacionale. Ministri i Brendshëm është institucion. Medies e ke për detyrë t’i japësh llogari; çdo medie që paguan taksa në këtë vend dhe paguan rrogën tënd, ti ke për detyrë t’i japësh llogari një për një.

Sa për informacionin, zoti Balla, që thoni: “Bëni 2 gisht letër për të marrë informacion”, nuk pres të marr informacion, pasi kam kërkuar informacion për tenderë miliona dollarë dhe kam marrë përgjigje tjetër nga ajo që është botuar në Fletoren Zyrtare. Kjo qeveri e ka bërë lekun letër, siç thotë populli, i janë errur sytë dhe nuk do t’ia dijë fare se çfarë kostoje marramendëse u krijon shqiptarëve.

**Gramoz Ruçi** – Këtu mbyllet debati për projektligjin “Për aderimin në amendamentin DOHA të protokollit të Kiotos të konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike”.

Kalojmë te projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”, ratifikuar me ligjin nr. 100/2017”. Janë regjistruar deputetët: Alket Hyseni, Vullent Sinaj, Anila Denaj, Niko Peleshi, Milva Ekonomi, Kujtim Gjuzi, Artur Roshi dhe Edlira Hyseni. Kush e kërkon fjalën për procedurë?

IT-ja, ju lutem!

Urdhëroni!

**Erion Piciri** – Faleminderit!

Për sa i përket çështjes së kohës së deputetëve të pavarur në seancë është dyfishuar koha e seancave plenare, por, me sa kam kuptuar, jo koha e fjalës sonë në parlament. Nëse është e mundur të flasim të paktën 5 minuta, pasi janë shumë çështje që do të vijnë në vazhdimësi deri në fund të këtij sesi. Të flasim 5 minuta që të përmbledhim një ide, të japim disa opinione lidhur me çështje të ndryshme që trajtohen në Kuvend. Parlamenti mbështetet te fjala, tek opinionet e deputetëve. Ju i keni votat,

keni gjithçka tjetër, por demokracia lidhet me pozicionimin, me qëndrimet që mbajnë deputetët. Prandaj, brenda mundësive, na jepni 5 minuta kohë të japim opinionin tonë për dhjetëra e dhjetëra çështje që trajtohen këtu në parlament. Kjo është esenca e demokracisë. Do të shtohet seanca me 30 minuta. Sikurse e kemi parë, janë hapur shkolla dhe shkojnë 7-8 orë. Duket si një lloj loje kjo për të na prerë fjalën, për të mos pasur mundësi të transmetojmë mendimet, idetë tona në lidhje me atë çfarë ndodh sot në Shqipëri.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Koleg deputet, në përgjigje të interesimit tuaj, Konferenca e Kryetarëve ka vendosur nga 2 orë në 4 orë, që do të thotë se janë 240 minuta, pra i bie më shumë se 1,9 minuta çdo deputeti në Kuvend. Kjo është bërë sipas Rregullores, megjithatë kjo varet nga ju, pra që të plotësohet kjo kërkesë, ju duhet të dakordësoheni se cili do të jetë numri i deputetëve të pavarur që do të flasin, ose emrat e tyre dhe brenda kohës së shumatores së minutave që i takon një deputeti me komplet numrin e deputetëve të pavarur, sigurisht mund të përmbushet edhe kërkesa juaj.

*(Ndërrhyrje nga salla)*

Po, thojeni edhe atë fjali.

**Erion Piciri** – Në bazë të studimeve që janë bërë në parlament, këtu flasin 25 deputetë dhe 100 të tjerë janë gojëmbyllur. Nisur nga kjo pikëpamje, nuk është çështje e 2 minutave. Lërimi njerëzit të flasin, ata që kanë mundësi të flasin dhe që kanë diçka në kokë për të folur! Pjesa tjetër janë ushtarë të bindur të partisë. Nisur nga kjo pikëpamje, nuk është çështje ushtarësh, por njerëzish që kanë mendje dhe transmetojnë një ide ndryshe në lidhje me shoqërinë.

**Gramoz Ruçi** – Koleg deputet, në radhë të parë, duhet të dish sesi organizohen grupimet parlamentare në çdo parlament demokratik të botës. Ata deputetë që thua ti kanë folur, kanë diskutuar, kanë debatuar në komisionet dhe në grupet përkatëse, u kanë dhënë legjitimitet të gjithë folësve të grupit për të shprehur mendimet teknike, profesionale, ligjore apo politike.

Fjala është për Alket Hysenin.

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë, së pari, meqenëse është seanca e parë e punës për këtë sesion, ju uroj

suksese, që nga Kryetari i Kuvendit dhe kujtdo nga ju...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

**Gramoz Ruçi** – Më falni, zoti Hyseni, a mund të uleni, sepse duhet të flasë një herë ministrja në fillim për të paraqitur projektligjin, se ka të drejtë, pastaj direkt pas ministres do ta merrni fjalën ju.

Fjala për ministren Denaj.

**Anila Denaj** – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Qëllimi i këtij projektakti është ndjekja e një procedure ligjore, e cila, në thelb, ka tërheqjen nga një marrëveshje ose, njohur ndryshe në terma juridikë: denoncim i marrëveshjes së huas.

Konkretisht, bëhet fjalë për marrëveshjen e huas midis Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit "Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës", i cili është ratifikuar në Kuvendin e Shqipërisë me ligjin nr. 100/2017. Projekti i rrugës së Lumit të Vlorës përbëhet nga 4 segmente apo ndryshe lote, ku loti 4 i këtij projekti ka pasur synim lidhjen e dy rrugëve Levan-Tepelenë-Gjirokastër me rrugën Vlorë-Sarandë, si dhe lidhjen e rajonit të Tepelenës me bregdetin jugor.

Në vlerësimet teknike të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të bëra bashkë me Fondin Shqiptar të Zhvillimit është gjykuar se lidhja e Tepelenës me bregdetin jugor po realizohet aktualisht nga një rrugë tjetër, një projekt i mbështetur nga Banka Botërore, i cili synon përfundimin brenda një afati kohor optimal të rrugës Gusmar-Kuç dhe rrugës Bënçë-Lekdush.

Sjell në vëmendje se tërheqja nga kjo marrëveshje është rakorduar mes të dyja palëve dhe përmes kësaj dakordësie me palën saudite do të adresojmë nevojat për sigurimin e financimit për projekte të tjera pa kosto shtesë në buxhetin e shtetit.

Gjej rastin të falënderoj në këtë moment të gjithë mbështetësit tanë, Fondin Saudit për Zhvillim, Bankën Botërore dhe të gjithë që kanë kontribuar për financimin e këtyre projekteve infrastrukturore, të cilët kanë pasur durim për të gjitha procedurat, të cilat në aspektin juridik kanë marrë një kohë të caktuar. Konstatoj se të gjitha punimet në këto rrugë janë në kohën e

duhur dhe shumë shpejt do të bëhet edhe inaugurimi i tyre përfundimtar.

Dua të theksoj se lidhja e bregdetit me këto zona malore ka një rëndësi shumë të madhe, jo vetëm sepse realizon një premtim të mbajtur të qeverisë “Rama”, por, njëkohësisht, edhe një ëndërr të të gjithë banorëve të këtyre zonave, të cilët për më shumë se 30 vjet presin interkonjeksionin e zonave malore me zonat urbane apo me bregdetin e Jugut. Njëkohësisht, jam e bindur se kjo do t’i sjellë një zhvillim shumë të madh turizmit, gërshtimit të turizmit bregdetar me atë malor. Një nevojë shumë e rëndësishme për t’u theksuar është edhe kthimi i banorëve në këto zona, të cilat janë deri diku të braktisura, për të punuar tokën e tyre, për të ngritur agroturizmin, si dhe për të zhvilluar biznesin e vogël.

Unë do të përfitoja nga minutat që kam në këtë foltore për të bërë dhe një raportim. Pas daljesh së djeshme të performancës së 8-mujorit, është një obligim qytetar për të raportuar se ku jemi në raport me projektbuxhetin.

Së pari, të ardhurat totale të 8-mujorit të vitit 2020 u realizuan në masën 270,7 miliardë lekë, ose 99,8%, në krahasim me rishikimin që i është bërë në muajin korrik aktit normativ në raport me të ardhurat. Kujtojmë se ky rishikim ishte i domosdoshëm pas dy goditjeve të njëpasnjëshme të tërmetit dhe pandemisë dhe parashikimet shikojnë një PBB të reduktuar në masën e 4,5%, pra negativ.

Buxheti i vitit 2021 shumë shpejt do të vijë për diskutim në komisionet parlamentare, kështu dua të rikujtoj se në vitin 2020 ne nuk shkurtuam asnjë zë të shpenzimeve kapitale dhe e bëmë këtë të ndërjegjeshëm, pasi është një mënyrë për të motivuar zhvillimin ekonomik dhe për të çuar përpara reformat e nisura edhe në aspektet e projekteve infrastrukturore. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019, ky zë ka rezultuar 4,3% më i lartë, ose rreth 13,4 miliardë lekë më shumë dhe kemi adresuar, sigurisht, me paketën e parë dhe të dytë shumën totale rreth 13 miliardë lekë për 300 000 shqiptarë.

Zonja Hajdari, unë dua të theksoj këtu se është shumë e rëndësishme që të gjitha nevojat e naftëtarëve t’i shikojmë në të gjithë kompleksitetin. Dua t’ju rikujtoj se në këto paketa është adresuar një fond prej 28,8 milionë lekësh për 721 naftëtarë. Më herët në këtë

Kuvend ne kemi aprovuar një fond prej 1,5 miliardë lekësh, një paketë kompensimi financiar për minatorët dhe naftëtarët, e cila është duke u adresuar proporcionalisht me të gjithë aspektin rregullator.

Nuk dua të përsëris aspak çfarë tha zoti Balla, por dua t’ju ftoj që për çdo shqetësim që keni, ato që kanë lidhje me detyrimet buxhetore, t’i diskutojmë në mënyrë të drejtpërdrejtë së bashku me ministrinë e linjës.

Për t’iu kthyer nevojës për raportim edhe në aspektin e shpenzimeve buxhetore, po ju them se janë miratuar 13 miliardë lekë nga dy fondet e garancisë për 751 biznese përfituese. Me aktin normativ që përmenda pak më parë kemi akorduar edhe për Fondin Shqiptar të Zhvillimit një shumë shtesë prej 3 miliardë lekësh. Shpërndarja e këtij fondi shkoi kryesisht për projekte, rehabilitim segmentesh rrugore dhe për rikualifikim urban në disa qendra qytetesh, si: Vlorë, Fier, Shkodër, Berat dhe Pogradec.

Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit janë alokuar edhe fondet për procesin e rindërtimit, duke përfshirë të gjitha zonat e goditura nga tërmeti i 26 nëntorit. Për pjesën që i takon fondit, që merr dhe menaxhon si njësi zbatuese Fondi Shqiptar i Zhvillimit, ka një total prej 11,6 miliardë lekësh, nga të cilat rreth 7,3 miliardë lekë janë alokuar për rindërtimin e banesave individuale dhe rreth 4,3 miliardë lekë për rindërtimin objekteve arsimore.

Më duhet të theksoj se janë 34 miliardë lekë të akorduara në fondin e rindërtimit, që menaxhohet nga Ministri i Shtetit për Rindërtimin.

Të gjitha këto i përmenda për të bërë një raportim, meqenëse shifrat paraprake kanë dalë ditët e fundit, por edhe për t’iu rikthyer temës që po diskutojmë, që zhvillimi infrastrukturor është një domosdoshmëri për të lidhur të gjitha zonat jo vetëm urbane, por edhe rurale, pasi biznesi i vogël dhe i mesëm në këto zona ka një nevojë të shtuar për këtë infrastrukturë, për të zhvilluar biznesin dhe për të realizuar fitimet e mundshme, që me ndryshimet që kemi bërë në muajin korrik në ligjet fiskale të tatimit dhe rritjes së pragut të TVSH-së, të ketë një mundësi të shtuar për ripunësim pas COVID-19-s.

Faleminderit!

*(Drejtimitin e seancës e merr zonja Hysi.)*

**Vasilika Hysi** - Faleminderit, zonja Denaj!

Faljen e ka deputeti Alket Hyseni. Të përgatitet deputetja Edlira Hyseni.

*(Deputetja Rudina Hajdari ndërhyr pa mikrofon nga salla)*

Jo. Ministria prezantoi nismën, nuk diskutoi.

*(Deputetja Rudina Hajdari ndërhyr pa mikrofon nga salla)*

**Alket Hyseni** - Faleminderit, zonja Nënkrjetare!

Është kënaqësi për mua, si deputet i qarkut të Vlorës, të diskutoj sot në këtë foltore për një projekt shumë të rëndësishëm të infrastrukturës së Shqipërisë, në radhë të parë, të infrastrukturës së qarkut të Vlorës, të një zone të cilën jemi mësuar ta mburrim për historinë e saj, jemi mësuar të krenohemi me luftën që bëri, por ka qenë lënë pas dore për dekada e dekada të tëra.

Projekti i rrugës së Lumit të Vlorës, që ishte një premtim drejtpërdrejt politik i Kryeministrit Edi Rama dhe i qeverisë së Partisë Socialiste, tashmë po bëhet realitet. I nisur me dy projekte huash, një nga Fondi Saudit dhe një tashmë i ezauruar, prej 40 milionësh, ky projekt mori rrugë, edhe pse kishte të meta të projektimit dhe, gjatë rrugës, Agjencia Shtetërore, e ngarkuar me implementimin dhe ekzekutimin e këtij projekti, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, duke ribërë projektin, duke e integruar atë me panin kombëtar dhe duke realizuar një konektivitet me zonën e Tepelenës dhe zonat përreth, mundësoi që qëllimi i këtij projekti të realizohej në një formë tjetër, duke e bërë të panevojshme ekzekutimin e një pjese të huas prej rreth 30 milionë dollarësh, pavarësisht se projekti nisi për 72 milionë dhe në total tashmë është mbi 80 milionë, sikurse e paraqiti edhe ministria.

Unë jam krenar për të prezantuar në emër të banorëve të Kotës, Sevasterit, Bratajt, Vllahinës, Armenit, Shushicës, që janë zona historike, që kanë bërë luftën e Vlorës, bashkë me të tjerat, por aty ka qenë zemra dhe shpirti i kësaj lufte; aty ka qenë shtabi i kësaj lufte; aty ka qenë aksi kryesor, që lidhte Vlorën me Tepelenën, ku ishin të rreshtuara batalionet italiane, që u hodhën në det; aty ishte shpirti luftarak dhe aty i kishte sytë gjithë Shqipëria dhe të gjitha trevat shqiptare në atë kohë, që sot mundësojmë që kjo zonë të lidhet me aksin kombëtar dhe të përmbillet unaza e Jugut të Shqipërisë. Tashmë banorët e kësaj zone, por edhe banorët e Tiranës dhe të

Prishtinës, që duan të shkojnë për turizëm në rivierën shqiptare, nuk do të kenë vetëm një aks në dispozicion, nuk do të kenë më vetëm drejtimin e Vlorës dhe të Llogorasë, aks i cili, pavarësisht bukurisë, është i tejngarkuar, por tashmë do të kenë edhe një mundësi të dytë për të shkuar shumë shpejt në Qeparo, Borsh, Lukovë, Himarë, Dhërmi, kudo, për të kaluar në Sarandë dhe për të bërë pushimet e tyre. Ky aks i rëndësishëm e afron rivierën shqiptare me tregun e madh turistik të vendit dhe të rajonit. Kjo jo thjesht ka rëndësi historike, siç e përmenda, por ka rëndësi primare ekonomike. Ky është një ndër akset me fizibilitet të shkëlqyer dhe, shtuar këtu edhe përmbylljen e unazës jugore me aksin e rrugës Kardhiq-Delvinë, një tjetër premtim i madh i bërë realitet nga qeveria e Edi Ramës, një tjetër 100-milionësh i hedhur në dispozicion të infrastrukturës, në shërbim të turizmit, mendoj se meritojnë një vlerësim të madh nga kushdo, nga secili banor i asaj zone, por edhe nga njerëzit që kanë sy për të parë dhe mend për të gjykuar, se veprat flasin vetë. Kjo nuk është çështje propagande, por është çështje realiteti. Hajdeni dhe shikojeni se çfarë zhvillimi ka marrë sot zona në këtë rrugë. Aksi po përmbillet deri në Kuç dhe unë jam i bindur që në pranverën e ardhshme do të kalojmë aty. Ndoshta secili nga deputetët, kur një pjesë juaja të shkojë për pushime, por edhe për ta parë këtë rrugë dhe për ta vizituar, do të kalojë shkurt nga kjo rrugë për të dalë në Qeparo.

Këto janë të rëndësishme për jetën e njerëzve, të cilët dëshirojnë ta ndërtojnë jetën aty, në ato fshatra, në ato zona, ku janë lindur dhe janë rritur, ku kanë qenë gjyshërit e tyre, për ta bërë turizmin, pse jo, tashmë fjetjen në Kuç dhe plazhin në Qeparo, Borsh, Lukovë e kudo tjetër.

Këto nuk janë projektet e vetme që janë vënë në dispozicion të turizmit. Ne jemi dëshmitarë të projekteve fantastike të Lungomares së Vlorës, për të vazhduar me shëtitoren e Dhërmiut, shëtitoren e Himarës dhe qendrën e saj, shëtitoren e Jalit, shëtitoren e Palasës, shëtitoren e Qeparoit, tashmë po ndërtohet edhe shëtitorja e bukur e Sarandës, bulevardi i ri i saj, i cili shpresoj se do të përmbillet në pranverë, për të mundësuar që në sezonin turistik ta shijojë çdo turist që do të vijë në Sarandë. Urojmë që të kemi një sezon më të

mirë vitin tjetër, duke uruar, së pari, fitimin e betejës me COVID-in, për t'u hapur rrugën turistëve të huaj, shqiptarë e mbarëshqiptarë, që të vijnë në Sarandë, në rivierën shqiptare, në Himarë, Vlorë e kudo!

Nuk është vetëm kjo. U realizua lidhja e Qeparoit me Tepelenën. Ka qenë një shteg i vështirë, por tashmë po kthehet në një rrugë turistike, që lidh Nivicën, kanionet e bukura të saj, për 30 minuta me bregdetin, që do të mundësojë krijimin e alternativave të tjera turistike, që turistët të mos rrinë vetëm në rërën e bukur të plazheve tona, por të kalojnë edhe në një nivel tjetër turizmi, në turizmin malor, në bukuritë e maleve tona krenare.

Unë do të doja që secili nga ju, duke parë që kjo marrëveshje është thjesht procedurale, që kalimi i fondeve nga një projekt në një tjetër është një menaxhim perfekt, ta votonte këtë marrëveshje pa asnjë dyshim, sepse me paratë e parashikuara në këtë hua jam i bindur që do të vazhdojë një tjetër vepër e madhe, po për qarkun e Vlorës: vazhdimi i Lungomares së Vlorës, loti i dytë dhe i tretë i saj, për ta bërë Vlorën jo thjesht qendrën e historisë, jo thjesht Vlorën e flamurit, por edhe një mbretëreshë të turizmit të Mesdheut, ashtu siç e meriton, për bukuritë natyrore që ka, për bregdetin e saj, por pse jo edhe për veçantinë e njerëzve të mirë e krenarë që ka ky qark.

Duke i kërkuar çdo deputeti votimin e kësaj marrëveshjeje, unë jam i bindur që edhe kolegët e opozitës, të cilët e votojnë marrëveshjen thjesht proceduralisht, janë në gjendje të kuptojnë që shpresa e vetme e shqiptarëve është qeveria e Edi Ramës, e Partisë Socialiste; është qeveria ku ka projekte të realizuara, premtime të mbajtura, ku ka ide, leadership, njerëz që punojnë, të cilët nuk janë perfektë, se edhe mund të gabojnë, por janë shpresa e vetme e të mirës së këtij vendi. Unë jam i bindur që qytetarët shqiptarë do të dinë ta vlerësojnë në kohën e duhur.

Dy fjalë për komisionin e posaçëm për përzgjedhjen e trupës së drejtuese të zgjedhjeve, ku unë do të jem anëtar. Unë e vlerësoj grupin tim parlamentar për përzgjedhjen time në këtë komision dhe i garantoj që ky do të jetë një komision i përkushtuar dhe do të realizojmë detyrën në kohën sa më të shpejtë të mundshme. Përtej pengesave që mund të na krijojnë të tjerët, përtej preteksteve që mund të

krijojnë palët e tjera, ky komision do të çojë në fund dhe do të përmbushë misionin që ka në bazë të vendimit të këtij parlamenti, por edhe në bazë të ligjit, për t'i dhënë Shqipërisë një trupë drejtuese zgjedhore me dinjitet dhe në pranverë zgjedhje të lira dhe të ndershme, pavarësisht se opozita, kryesisht ajo e rrugës, jam i bindur që do të krijojë pengesa, sepse ata nuk e kanë tek emrat, por e kanë filozofi këtë. Ata kanë filozofinë që ditën e parë i pranojnë marrëveshjet, sepse ditën e parë i bën Luli; ditën e dytë Luli justifikohet se nuk i ka lexuar te doktori, dhe ky i fundit, pasi konsultohet ditën e tretë me Presidentin, i anulon ato. Le të urojmë që edhe për këto përzgjedhje të mos kalojnë në këto tri etapa dhe të mos gjendemi në situatën ku ditën e parë në komision përfaqësuesi i tyre të japë ndonjë propozim, ditën e dytë ta ndryshojë doktori dhe ditën e tretë ta anulojë Presidenti.

Ju faleminderit!

**Vasilika Hysi** - Faleminderit, zoti Hyseni!

Fjalën e ka deputetja Edlira Hyseni. Të përgatitet deputeti Vullnet Sinaj.

*(Deputetja Rudina Hajdari ndërhyr pa mikrofon nga salla)*

Zonja Hajdari, ju nuk e keni kërkuar fjalën. Po e shoh monitorin dhe nuk e keni kërkuar fjalën. Tani e ndezët mikrofonin.

**Rudina Hajdari** - Ajo që dua të vë në dukje për sa i përket çështjes së ARMO-s, edhe pse e sjell në vëmendje para parlamentit sot, zonja Denaj, është fakti që, nga momenti kur është privatizuar, 12 vjet më parë, ky biznes ka akumuluar 900 milionë dollarë borxh ndaj shtetit, pra ka krijuar borxhe edhe ndaj jush, ndaj palëve të treta, çka është më e keqja, edhe ndaj atyre punëtorëve që punojnë natë e ditë. E sjell në vëmendje këtë çështje për arsyen se gjatë gjithë kësaj kohe, pra për 12 vjet, si në atë pushtet, si në këtë pushtet, nuk jeni marrë me të dhe sot naftëtarët enden nëpër rrugë e procedohen për protestat që bëjnë, sepse nuk janë paguar për punën që kanë bërë. Pra, nuk ka një kontratë, ku të mbrohen këta punëtorë, ashtu siç duhet të mbrohen dhe kjo shkon përtej faktit që naftëtarët sot enden nëpër rrugë për të kërkuar pagat e tyre, sepse e vërteta është që ato burime natyrore, ajo naftë në Ballsh nuk është se kanë mbaruar, janë ende aty nën tokë, edhe rafineria punon, edhe tregu për atë naftë vazhdon. Por ajo që ka ndodhur këtu është se qytetarët e thjeshtë

nuk paguhen dhe nuk mbrohen, ata njerëz që nuk punojnë, që janë biznesmenë dhe që merren me këtë punë, nuk punojnë absolutisht asnjë ditë dhe janë ata që mbrohen në këtë vend, janë njerëzit që i kanë krahët e mbrojtura nga shteti. Unë sot po kërkoj që ne si parlament dhe kushdo që do të vijë këtu, të flasë një herë për këta njerëz, të ngremë zërin për ta, sepse ata nuk punojnë vetëm në atë rafineri, por punojnë nëpër minierat që prodhojnë krom, punojnë në vende të ndryshme, që sot janë marrë nga një grup njerëzish të pangopur...

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zonja Hajdari!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja Hajdari, ju lutem, ju e bëtë replikën dhe nëse keni nevojë për informacion, mund të përdorni të gjithë instrumentet e kontrollit parlamentar për të adresuar shqetësimet e naftëtarëve, që nuk janë shqetësime vetëm tuajat, por të çdo deputeti në këtë sallë.

Fjalën e ka deputetja Edlira Hyseni.

Ju kërkoj ndjesë, zonja Hyseni!

Të përgatitet deputeti Vullnet Sinaj.

**Edlira Hyseni** – E nderuar drejtuese e seancës parlamentare,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Që na ndiqni, që keni dëshirën dhe durimin të na dëgjoni, që keni një interes të drejtë për informim dhe pjesëmarrje publike dhe politike e ndoshta edhe dëshirën për ndonjë sharje për ata që bëni përgjegjës për çdo gjë që ndodh rreth nesh, do të doja t'ju thosha se unë mendoj që sot fuqinë e ka leku dhe pushteti, dhe këtë e ka qeveria, kurse në këtë Kuvend fuqinë e ka fjala dhe vota, por, meqenëse me votimet përgjithësisht nuk shkëlqejmë shumë, le të mbetemi te mendimi që shprehim duke shpresuar që të jemi sa më shumë që mendojmë njëlloj.

Në këtë fjalë të parë të këtij sesioni parlamentar, që sapo ka nisur, përballë prioritetit absolut në këtë situatë pandemie, që është shëndeti, më lejoni t'ju uroj të gjithëve një vjeshtë dhe një dimër të mbarë dhe të qetë, ku preokupimi i vetëm të jetë gripi sezonal i zakonshëm dhe ky virus, që na ka hequr çdo normalitet, të zhduket ashtu siç erdhi apo të kalojë sa më shpejt, për të na lënë të marrim frymë lirisht pa maska dhe ndërkohë që presim

që kjo të ndodhë, lë të vijojmë të zbatojmë masat e kujdesit për veten dhe ndaj njëri-tjetrit!

E kam kërkuar fjalën për çështjen në rendin e ditës lidhur me denoncimin apo anulimin nga pala shqiptare të një huamarrjeje të miratuar në vitin 2017, në vlerën 30 milionë dollarë, në një marrëveshje të lidhur me Fondin Saudit të Zhvillimit, që parashikonte të financonte pjesën e dytë ose lotin 4 të projektit për rehabilitimin dhe rikonstruktimin e rrugës buzë Lumit të Vlorës.

Në fakt, ky ligj, që anulon këtë borxh, duhet të përbëjë një haber të mirë, sepse do të thotë që në njëfarë mënyre po ulim borxhin publik, i cili sot është i lartë, jemi afër 80% të PPB-së, sipas parashikimeve më të fundit. Një nga arsyet që është dhënë në relacion është që ky anulim, nëpërmjet këtij ligji që kalon sot, bëhet edhe për efekt të pasqyrimin të saktë të borxhit publik të Shqipërisë, por meqenëse besimi për qëllimet e mira ka ca kohë që lë për të dëshiruar, ngrihen disa pyetje: pse një kredi e përfituar me kushte mjaft të leverdishme, që ka një kosto interesi 2%, ka mundësinë e 5 vjetëve të para pa pagesë, pa detyrim shlyerjeje principali dhe një afat maturimi 25 vjet etj, pra pse një kredi kaq e leverdishme nuk u bë efektive në 3 vjet? Ishte një mundësi, një borxh i miratuar në këtë Kuvend, me ligjin nr. 100 të vitit 2017, pra 3 vjet më parë, dhe nuk u shfrytëzua. Pse sot vlerësohet si pa interes dhe tepër i kushtueshëm loti 4 i rrugës buzë Lumit të Vlorës? A mban kush përgjegjësi për ato projekte fillestare, për ato përllogaritje, që duket se janë të gabuara, të pasakta apo të padobishme, që sot ndryshojmë këtë vendim? A mund të përdorej kjo kredi, që ka qenë e disponueshme në këta tre vjet, duke kërkuar një ndryshim objekti për financim të projekteve të tjera investimi në ato zona, apo përreth? Unë kërkoja në komision informacion për këtë nëse anulohet, apo ka një mundësi rialokimi, apo ripërdorimi për projekte të tjera dhe më thanë që jo, nuk ka një ide të tillë për momentin. Pyes se si janë vlerësuar, gjykuar, ndryshuar dhe konsultuar nevojat e banorëve të atyre zonave, të cilëve u keni premtuar se do të bëhej edhe loti 4, ndërkohë që sot po u themi që është ndryshuar projekti? Si do t'ua shpjegoni që ndërruat mendje?

Në këtë vit të pazakontë, që e ka detyruar qeverinë shqiptare t'u drejtohet tregjeve dhe institucioneve ndërkombëtare dhe financiare për

nevojat e buxhetit dhe huamarrje të reja në vlera të larta, me kosto dhe kushte jo kaq të favorshme, a nuk duket si e çuditshme të heqim dorë nga një hua e tillë me kushte të favorshme?

Së fundmi, a kemi garanci dhe siguri të plotë që kjo prishje e marrëveshjes ndërkombëtare mes dy palëve, e miratuar në Kuvend në 2017-n, nuk do të pasojë me ndonjë penalitet gjobe, apo dëme të tjera financiare për buxhetin e shtetit, ashtu siç jemi përballur me faturën e kripur të dy rasteve të njohura si Begheti dhe kompania greke ACTOR, që tashmë dihet se është një detyrim prej 154 milionë eurosh, i lindur kohët e fundit?

A jemi të sigurt se nuk kemi një rrezik të tillë edhe në këtë rast?

Në Komisionin e Ekonomisë përfaqësuesit e Ministrisë së Financës dhe FSHZH-së, të vetmit që u prezantuan për të shpjeguar këtë ligj, na dhanë arsyetime të paqarta. Nga Ministria e Financës na u tha që në këta tre vjet i është bërë kërkesë Fondit 3 herë për disbursimin e kësaj shume, por nuk është pranuar dhe nuk na shpjeguan pse, ndërkohë që nga FSHZH-ja na thanë që në këta tre vjet nuk kanë qenë ende gati të përthithnin ato fonde për shkak të fazave të zbatimit të projektit. Në fakt nga FSHZH-ja na u tha që aktualisht gjykohet që ata 30 milionë dollarë për 16 kilometra aks rrugor, të parashikuar, janë një kosto tepër e lartë në krahasim me 45 milionë dollarë që kanë bërë 3 lote. Këto shifra na u thanë, madje sot dëgjova edhe 80, apo shifra të tjera, ndaj nuk e kam të qartë këtë pikë. Gjithsesi më lind pyetja: nëse u deshën 3 vjet për të konstatuar se 30 milionë dollarë janë shumë për 16 kilometra, çfarë na bën të mos dyshojmë që janë bërë të tilla vlerësime të gabuara edhe në projekte apo në investime të tjera me vlera të mëdha, që janë mbaruar, ose janë në proces? Unë nuk e di nëse gjërat janë kaq të thjeshta sa duken, apo ka elemente që nuk i njohim, por mendoj se ka nevojë për transparencë dhe përgjegjësi në çdo nivel nga ata që marrin vendime dhe bëjnë projekte fillestare, pastaj shumë shpejt ndërrojnë mendje, apo u dalin llogaritje ose prioritete të tjera. Dikush duhet të përgjigjet për zgjedhjet që bën, sepse pak kohë më parë është bërë, ndryshe ne do të vazhdojmë të prezantojmë dhe të miratojmë projekte me pak kilometra rrugë dhe me shumë miliona në diskutim dhe do të themi që është

vlerësuar gabim, që nuk është ai prioritet dhe do të shohim diçka tjetër. Nga FSHZH-ja në komision na u tha që është kuptuar që ai aks mund të zëvendësohet me alternativa më ekonomike, 3 deri në 5 milionë euro. Po të ishin këto zgjidhje, duhet të ishin menduar që në fillim dhe jo sot.

Unë nuk arrij të gëzohem që do të ulet borxhi publik, që tashmë i ka kaluar 10 miliardë euro me këta 30 milionë dollarë, më shumë më vjen keq për ata banorë, të cilëve u ishte premtuar dhe prisnin të lidheshin fshatrat dhe zonat me atë aks rrugor, sepse sinqerisht mendoj që pak mirëqenie më shumë për ata vlen më tepër sesa një buxhet, që këto kohë mbahet me vështirësi në këmbë, ndoshta për faj të shpenzimeve të tjera të gabuara apo të panevojshme.

Meqenëse jemi në çështje ekonomie dhe sezoni turistik po mbaron, kisha një falënderim për çdo shqiptar, edhe të trojeve tona përreth, që në këtë sezon turistik vendas i bënë jehonë dhe përcollën dashuri për vendin dhe bukuritë e tij. Ne dimë të tregojmë se e duam këtë vend, por ama me mbarimin e sezonit turistik rikthehet një sfidë e madhe për punën dhe mbijetesën e individit, të familjeve dhe të bizneseve shqiptare. Sektorët e turizmit, shërbimi i transportit dhe bujqësia rikthehen në vështirësi.

Në lidhje me kushtet e pas tërmetit dhe të pandemisë, me përfundimin pak a shumë të efekteve financiare të të dy paketave ndihmëse, që mori qeveria, kisha disa pyetje, që besoj se i kemi të gjithë: a mbaroi hartimi i atij programi ekonomik të rimëkëmbjes së vendit, që u diskutua në qershor (është prezantuar si ide që ishte në proces), a e kemi sot një plan të tillë gati dhe cili është ai?

A do të ketë një paketë të re masash mbështetëse për biznesin shqiptar, që është në vështirësi, dhe për individët që kanë humbur vendet e punës dhe që do të jenë në hall të madh?

A është aktiv dhe a kryen ndonjë veprimtari konkrete komiteti teknik i rindërtimit të pas tërmetit? Nuk e kam parë kund, shoh vetëm fotot, por jo komitetin.

A është i përgatitur buxheti ynë për mbështetje emergjente të shëndetësisë në rast nevoje dhe a do të vazhdojmë të paguajmë ende për tamponët në shtet? Durrësi dhe zonat e prekura nga tërmeti janë prioritete që kërkojnë



zgjidhje, sepse kanë çështje jetike, si: rindërtimi, strehimi, arsimi, qetësia dhe buzëqeshja, që u mungojnë, kërkojnë përgjigje se ku jemi sot. Zoti Ahmetaj nuk është këtu për të na informuar diçka të shkurtër, por Durrësi është kthyer në një kantier ndërtimi dhe jo për rindërtimin nga postërimi, por me sa duket me lejet e ndërtimit është lëshuar dora...

*(Zonjës Hyseni i ndërpritet fjala, sepse i ka mbaruar koha në dispozicion)*

**Vasilika Hysi** – Zonja Hyseni, mund ta shikoni që koha ju ka përfunduar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Vullnet Sinaj. Më pas e ka kërkuar fjalën ministria Denaj.

**Vullnet Sinaj** – Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar banorë të Selenicës dhe të fshatrave përreth.

Për mua ka qenë shumë më e lehtë kur në nëntor të vitit 2017 miratuam marrëveshjen e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për rehabilitimin e rrugës së Lumit të Vlorës, sidomos atë të lotit 4, Peshkopi – Selenicë dhe Levan – Tepelenë. Ndërsa sot e kam shumë të vështirë të marr pjesë në këtë seancë dhe të diskutoj për denoncimin e kësaj marrëveshjeje huaje.

Të gjithë e dimë që rruga e Vlorës përbëhet nga 4 lote. Loti i parë ka mbaruar, i dyti dhe i treti janë në zhvillim dhe puna ka vazhduar shumë mirë. Kjo vepër u ka ardhur në ndihmë banorëve të zonës duke i lidhur me bregdetin, pra është një vepër e padiskutueshme për nga madhësia e saj. Por denoncimi i kësaj marrëveshjeje më detyron të flas dhe të vë në diskutim mënyrën se si e ka vlerësuar fizibilitetin Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Nëse kjo marrëveshje do të ishte miratuar sot zona e Selenicës, e Karbunarit dhe e Gorishtit do të ndodheshin në të njëjtën gjendje siç ndodhet dhe zona tjetër që u lidh me bregdetin, pra do të lidheshin me rrugën Levan – Tepelenë nëpërmjet urës dhe nuk do të vazhdonte më historia e gjemisë.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka bërë një gabim të madh në studim, sepse ka harruar që zona e Selenicës është një zonë industriale, ku ndodhet miniera shekullore e Selenicës, ku ndodhen minierat zhavorre dhe bituminoze, ku

ndodhet ndërmarrja e madhe e naftës në Gorisht, e cila i ka dhënë miliona dollarë shtetit shqiptar.

Së dyti, ka harruar të vlerësojë nevojën e komunikimit mes krahinës së Mallakastrës dhe të Labërisë, një komunikim i kahershëm që kur ka lindur jeta në këtë tokë, por që e vlerësojmë dhe e shikojmë shumë mirë në komunikimin dhe në marrëdhënien që ka pasur qyteti i lashtë i Byllysit në Mallakastër dhe i Amantias në Labëri, që në shekuj kanë qenë të lidhur nëpërmjet lumit Vjosë.

Edhe një herë dua t'i vë në dukje Fondit të Zhvillimit që rruga më e shkurtër nuk është ajo që lidh fshatrat e Karbunarit, të Gorishtit, të Armenit dhe të Selenicës me rrugën Levan – Tepelenë me Greqinë apo edhe me Tiranën. Le ta gëzojnë Tepelena, Bënça dhe Gusmari rrugën. Kur dëgjova kolegun Alket Hyseni që diskutonte me patos për këtë gjë, mu bë qejfi për të, por jo për veten time, si deputet i asaj zone, ku unë kam lindur dhe e njoh shumë mirë situatën në atë zonë, sepse bëhet fjalë për anulimin e lotit të katërt. Pra, që t'i thuash një banori të Gorishtit apo të Karbunarit që të shkojë në Tiranë dhe të kalojë nga Kuçi, Gusmari, Bënça dhe nga Tepelena është njësoj sikur të kapësh veshin e majtë me dorën e djathtë dhe nga mbrapa koke. Pra, nuk është rruga më e shkurtër.

Të nderuar kolegë, për arsytet që unë ngrita dhe, po ashtu theksoj që ndodhem në një moment shumë të vështirë, por koha kërkon që unë të jem kundër votimit të denoncimit të kësaj marrëveshjeje.

Unë shpresoj se qeveria shqiptare dhe Kryeministri do ta vlerësojnë qartë situatën në atë zonë, sepse ka mundësi shumë më të mëdha për ta lidhur Selenicën, Karbunarin, Gorishtin, Vllahinën me aksin e urës së Poçemit, që e lidh atë me rrugën Levan – Tepelenë.

Faleminderit për vëmendjen dhe për mirëkuptimin!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Sinaj!

Fjalën e ka Ministria Denaj. Më pas e ka deputeti Niko Peleshi.

**Anila Denaj** – Dua të bëj dy korrigjime në lidhjen me aspektet që diskutohen me detaje në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, ku zonja deputete është anëtare aktive, të cilën e falënderoj gjithmonë për pyetjet që bën, por këtu na solli një pasqyrë komplet kaotike. Nuk është e vërtetë që të gjitha problematikat, që lidhen me

rialokimet ndikojnë apo kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me borxhin.

Po, rritja e borxhit është fakt. Unë përmenda pak më parë edhe çështjen që lidhet me parashikimet buxhetore të fundit të vitit apo ato të realizuara gjatë 8-mujorit.

Kjo rritje e deficitit vjen si rezultat i ndërtesave në Durrës, në Tiranë, në Thumanë, pra në të gjitha zonat e dëmtuara nga tërmeti, sikurse edhe nga nevoja për shpronësime e detyrime që duhet të shkojnë tek ata që e meritojnë, apo në infrastrukturë për të përfunduar rrugët në zonat rurale, për t'ua bërë jetën më të mirë banorëve të atyre zonave apo edhe për t'i rikthyer ata.

Unë i kuptoj emocionet e deputetëve të çdo zone. Përgjithësisht, si ministre e Financave, mendoj që lehtësia e kësaj ftohtësie lidhet vetëm me faktin që këto rrugë janë për të gjithë shqiptarët. Kalimi nga një lot tek tjetri duhet lënë në dorë të teknikëve dhe të specialistëve në fushën e ndërtimit për të përcaktuar nëse këto rrugë janë optimale. Jo vetëm kaq, por rrugët paralele, si është ajo që unë përmenda dhe që do të financohet nga Banka Botërore, duhet të akomodohen sa më mirë për të gjitha nevojat dhe për të gjithë shqiptarët në të gjitha zonat.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka deputetit Niko Peleshi. Të përgatitet deputeti Artur Roshi.

**Niko Peleshi** – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Në lidhje me këtë që quhet denoncim marrëveshjeje dua të them që kur hiqet dorë nga një investim, deputeti apo komuniteti i zonës që preket ka të drejtë të ankohet. Por, duke e parë pak më gjerë, të gjithë e dimë që Shqipëria, si çdo vend tjetër, ka shumë nevoja. Edhe në vendet e zhvilluara nevojat janë gjithmonë shumë më të mëdha sesa mundësitë. Meqenëse kemi më shumë nevoja se mundësi, na duhet të bëjmë ekonomi. Një qeveri e mirë është ajo që bën ekonomi, që i rrit vlerën parasë, që zgjedh projektin më fizibël dhe që kursen sa më shumë.

Për ironi, qeveritë e vendeve më pak të zhvilluara dhe më të varfra planifikojnë më keq dhe e bëjnë më keq këtë punë, ndërkohë që duhet të ishte e kundërta. Këtu kemi të bëjmë me të

kundërtën, pra kemi të bëjmë me një Ministri Financash dhe me një qeveri, që kanë bërë një vlerësim duke gjetur rrugën më të shkurtër, një zgjidhje më të mirë për të realizuar të njëjtin qëllim. Qëllimi është që të lidhim një zonë me potencial shumë të madh agroturistik të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, siç është zona e Tepelenës me bregdetin, të cilat janë kaq afër dhe kaq larg. Për të arritur këtë qëllim, përmes rrugës Gusmar – Kuç, që po realizohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, përdoren rreth 7 – 8 milionë euro, ndërkohë që me marrëveshjen nga e cila po tërhiqemi do të duhen më shumë se 60 milionë euro. Pra nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, ne po bëjmë ekonomi.

Më vjen keq që mora gjysmën e kohës për ta shtjelluar, sepse ministrja dhe parafolësit ishin shumë të qartë, por unë dua ta vendos në një kontekst pak më të gjerë. Nga segmenti i rrugës Gusmar – Kuç dhe me disa investime të tjera në aksin nga Korça deri në Leskovik e Përmet banorëve të zonës që unë përfaqësoj, që është qarku i Korçës, u përgjysmohet koha për të dalë në bregdetin e Jugut. Pra, nga 6 orë që na duhet sot, sepse duhet t'i biem rreth e rrotull përmes Elbasanit, Vlorës dhe Llogorasë për të shkuar në bregdetin e Jugut, për 3 orë, 3 orë e gjysmë do të jemi në Qeparo, pra nga Korça në bregdetin e Jugut.

Ky është një lajm shumë i mirë për të gjithë korçarët, por edhe për të gjithë shqiptarët, sepse më në fund pas 100 vjetësh në Shqipërinë lindore po investohet. Mungesa e investimeve në infrastrukturën e Shqipërisë lindore nga Dibra dhe deri në bregdetin e Jugut, Gjirokastër dhe më poshtë deri në Sarandë, ka bërë që këto zona të shpopullohen. Ne nuk flasim për shpopullimin ose flasim shumë pak, por shpopullim do të thotë që potenciale të tëra të këtij vendi kaq të vogël t'i lëmë të pashfrytëzuara, sepse nëse nuk ka njerëz nuk e shfrytëzojmë dot bujqësinë dhe blegtorinë e këtyre zonave.

Lidhja e infrastrukturës jugore me bregun e Jugut u jep mundësi për një jetë më të mirë të gjithë banorëve të këtyre zonave. Prodhimet e tyre do të shkojnë shumë më shpejt te konsumatorët e bregdetit dhe tek turistët, numri i të cilëve gjatë sezonit të verës rritet shumë, po ashtu edhe konsumi.

Korça përmes rrugës Qukës – Qafë Plloçë do të lidhet për më pak se 2 orë me Tiranën, e

cila është metropoli dhe ka tregun më të madh shqiptar. Kur lidhet Korça do të thotë që jo vetëm njerëzit shkojnë më shpejt aty, por edhe prodhimet e fushës së dytë më të madhe bujqësore, që është fusha e Korçës së Maliqit, do të shkojnë më shpejt në këtë treg të madh për konsumatorët.

Edhe rruga Dibër –Librazhd është në rrugën e duhur, është gjetur financimi dhe do të asfaltohet, pra do të lidh zonën e Dibrës me korridorin e tetë. Kjo, në fakt, është akoma në letër, por me zhvillimet e planifikuara do të jetë shpejt një realitet.

Dje kemi folur me kryetarin e grupit tonë për fillimin e studimit të segmentit nga hyrja e Elbasanit deri në Qukës, që do të thotë bajpasi i Elbasanit dhe zgjerimi me 3 korsi i rrugës deri në Qukës, pra nga Elbasani në Librazhd dhe deri në Qukës. Pastaj hyjmë në rrugën Qukës – Qafë Plloçë, e cila i ka siguruar të gjitha burimet e financimit për të lidhur zonën e Korçës me të Elbasanit në më pak se dy orë, pra me rreth 1 orë e gjysmë.

Në fund të çdo pakete projektesh, si në fushën e infrastrukturës rrugore, por edhe të “Rilindjes urbane”, për të cilën nuk pata kohë të flas por do të flas më vonë, qëndron ekonomia, prandaj ky mozaik rrugësh, ashtu si ai mozaik investimesh nëpër qytetet dhe fshatrat tona, në fund fare ka prodhuar më shumë punësim, më shumë ekonomi dhe më shumë biznese. Ky është qëllimi final dhe jo t’i shqyrtojmë si copëza segmente rrugësh.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Peleshi!

Fjalën e ka deputeti Artur Roshi. Të përgatitet deputeti Kujtim Gjuzi.

Të nderuar deputetë, ata që nuk kanë maska, t’i vendosin ato. Virusi nuk është larguar dhe ne jemi në kushtet e pandemisë.

Faleminderit për mirëkuptimin!

**Artur Roshi** – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Në seancën e fundit plenare, Kryeministri me gjuhën e urrejtjes dhe të dhunës adresuar një shtrese të caktuar të shoqërisë tregoi një bipersonalitet politik, duke parë edhe anën tjetër të tij, atë që ai i ka servirur publikut si modern që vlerëson negativisht diktaturën, pavarësisht lidhjeve organike që ka me të. Gjithashtu,

Kryeministri ofendoi dy kolege deputete vetëm pse votuan kundër ndryshimeve kushtetuese; është po ky Kryeministër që kërkon t’u mbushë mendjen shqiptarëve se do të mbajë 1/3-n e listës së mbyllur për të respektuar gratë. Ajo që dua të di është: a i ka marrë në shqyrtim, në këtë rast komisioni i etikës, sepse ky komision ka qenë sensibil për shkeljet që kanë ardhur nga kjo ana këtej e sallës, pra nga ana e djathtë e opozitës, apo komisioni mendon se, me ndryshimet e fundit kushtetuese për moslejimin e koalicioneve, Kryeministri është drejt fitimit të një statusi tjetër jo të deputetit, por atë të perandorit?!

Së dyti, nëse Kryeministri në fjalën e tij i drejtohet një deputeti, i cili përfaqëson një linjë të caktuar politike, të ndryshme nga të tjerat, mendoj se përbën argument të integruar në frymën e Rregullores së Kuvendit për t’i dhënë kohën e replikës, pavarësisht shprehjes eksplicite të Rregullores. Ky është një precedent që duhet gjykuar në frymën e Rregullores nga Kryetari i seancës. Kryeministri ra në nivele vulgare kur përdori fabulën e një bejtexhiu, të Shefqet Musarajt, si pikën e Arkimedit për të goditur elitën e kombit, për të goditur Mithat Frashërin dhe historinë e Ballit që, në mos është tharmi i gjithë historisë sonë kombëtare, me të cilën duhet të krenohemi, të paktën është gjysma e saj.

Historia nuk është më pronë e Kryeministrit apo e Partisë Socialiste, e cila mundohet të qëndrojë me një këmbë në socializëm dhe me tjetrën në kapitalizëm. Dua t’i them Kryeministrit se të jesh në anën e bolshevizmit dhe e krimeve të tij, nuk do të thotë se je në anën e duhur të historisë, përkundrazi.

Në vitin 2020 nuk është demode të jesh ballist, siç thotë Kryeministri, sepse të jesh ballist do të thotë të jesh republikan amerikan, të jesh konservator anglez apo konservator gjerman, duke marrë kështu vendet më të zhvilluara të Perëndimit. Të jesh socialist, kur në vendet më të zhvilluara të Perëndimit, në Angli, në Gjermani, por edhe në Amerikë, si dhe në shumë vende të tjera nuk ka Parti Socialiste, nuk është se përbën sens modernizmi apo je në trendin e historisë politike që po jetojmë. Kështu që qëndrimi i Kryeministrit, në njëfarë mënyre, në vazhdimësinë e të parëve të tij politikë është një dumbabizëm politik. Ky është Kryeministri dhe kjo është Partia Socialiste.

Le të vijmë te çështja e denoncimit të huas ndaj Fondit Saudit të Zhvillimit. Denoncimi që i bëhet kësaj huaje, që shteti ynë ka marrë nga Fondi Saudit i Zhvillimit për lotin e katërt të Lumit të Vlorës, si segment që mundëson aksesimin e një zone të konsiderueshme drejt detit, tregon se qeveria shqiptare nuk ka prioritete dhe hierarki fizibiliteti të projekteve zhvilluese të vendit. Çdolloj marrëveshjeje e përfshirë, edhe ato të huas...

*(Deputetit Artur Roshi i ndërpritet fjala, sepse i mbaroi koha në dispozicion)*

**Vasilika Hysi** – Po, mund të vijoni.

Ju lutem, teknika, le ta përfundojë fjalën!

**Artur Roshi** – Faleminderit!

Metodologjitë e qeverisë për zhvillimin e projekteve të ndryshme në infrastrukturë janë të pastuduara në konceptin unik të zhvillimit të ekonomisë së vendit dhe janë kaotike. Motivimi i prishjes së kësaj huaje nga qeveria se loti katër i Lumit të Vlorës kushton më shumë sesa është marrë huaja, besoj se është një justifikim dhe nuk është arsye. Qëllimi i qeverisë është t'i adresojë fondet në zona të tjera dhe të ketë një *feedback* të marrjes së votave të mirëpërcaktuar për zgjedhjet që do të vijin. Argumenti i qeverisë se loti i katërt i rrugës së Lumit të Vlorës...

**Vasilika Hysi** – Zoti Roshi, mos bëni fjalimin nga fillimi, sepse thatë se do të mbyllnit fjalën. Ju kërkohet ndjesë tani...

**Artur Roshi** – Jo fjalimin, por vetëm dy fjali.

**Vasilika Hysi** – Ju lutem!

Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Kujtim Gjuzi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ndjesë, zoti Gjuzi!

Po, zonja Kodheli, për procedurë 3 minuta.

**Mimi Kodheli** – Në fakt, 30 sekonda më mjaftojnë për të thënë se të jesh pjesë e së majtës progresiste dhe Partisë Socialiste është një nder për këdo që është pjesë e saj, sepse është pjesë e së majtës progresiste mbarëbotërore dhe nëse quhesh ballist jo domosdoshmërisht duhet të jesh republikan. Kështu që partitë janë pasuri kombëtare...

*(Deputeti Artur Roshi flet pa mikrofon.)*

**Vasilika Hysi** – Zoti Roshi, ju tërheq vëmendjen për shkelje të Kodit të Etikës!

**Mimi Kodheli** – Fjalimin e zotërisë e konsideroj si një ofezë që u bëhet atyre që janë

pjesë e Partisë Socialiste progresiste në këtë vend, ndaj e mora fjalën për procedurë.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Shumë faleminderit, zonja Kodheli!

Fjalën e ka deputeti Kujtim Gjuzi.

Ndjesë, i nderuar koleg!

**Kujtim Gjuzi** – Faleminderit, zonja Nënkrjetare e Kuvendit!

*(Deputetja Mimi Kodheli flet pa mikrofon.)*

Zonja Kodheli, a mund të flasim edhe ne? Zonja Kodheli, mos u bëni si unë, se e keni vënë firmën e para për të më ndihmuar!

**Vasilika Hysi** – Zoti Gjuzi, mund të vijoni!

**Kujtim Gjuzi** – Shqiptarë, vetë fjala “denoncim” do të thotë të denoncosh. Vetë qyteti i Selenicës në këtë moment, meqenëse ka votues të djathtë, duhet të bllokohet. Siç e tha edhe deputeti socialist, zoti Vullnet, i cili duhet përgëzuar, ky ndryshim në minutat e fundit është pikërisht për të dalë nga zona e Kryetarit të Kuvendit, zotit... Nuk kam çfarë të bëj se Kryetari nuk është këtu, ndaj nuk po ia përmend emrin, se do t'i mbetet hatri.

Kryetar i Kuvendit, rruga do të kalojë nga sipër, sepse atje është zona majtiste, kurse kjo zona këtu, në fakt, është zonë e djathtë, por edhe më shumë e Ballit Kombëtar, siç e thanë edhe kolegët. Prandaj bllokohet ky investim dhe nuk është çështje borxhi, sepse për çështjet e borxhit “Rilindja” ka 7 vjet që nuk bën asnjë kilometër rrugë. Ai ka thënë se do të bëjë autostradën joniane. Ku është autostrada, shqiptarë?! Në fakt, këta janë mashtruesit e Partisë Komuniste, të Partisë së Punës dhe të Partisë Socialiste, por jo e gjitha, se janë mashtruesit e “Rilindjes”, krimin, drogës dhe të gjithë të tjerave çfarë vijin mbrapa, por do të ikin edhe këta. Vetëm një qeveri akademike mund ta bëjë këtë punë, jo Edi Rama. Jo, Edi Rama nuk e bën dot, sepse ai bën projekte dhe këtu thotë se nuk ka dëm financiar. Si ekonomist, ju them se dëmi financiar ekziston, se në fillim është bërë projekti dhe janë paguar para.

Faleminderit, zonja Nënkrjetare!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Gjuzi!

Këtu mbyllen diskutimet.

Kalojmë në shprehjen në emër të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka deputetja Milva Ekonomi.

**Milva Ekonomi** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qëllimi i këtij projektligji që po diskutojmë sot është ndjekja e procedurave ligjore për denoncimin e marrëveshjes të ratifikuar me ligjin nr. 100/2017. Në kuptimin ligjor, fjala “denoncim” do të thotë prishje marrëveshjeje.

Ne kemi një marrëveshje që mban numrin 100/2017, e cila do të financonte një pjesë të ndërtimit të rrugës së Lumit të Vlorës dhe ky ishte loti i katërt. Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës ishte i përbërë nga katër lote. Loti i parë ka përfunduar, ndërsa loti i dytë dhe i tretë janë në proces ndërtimi. Ndërkohë, po të shikojmë të gjithë projektligjin, janë tri gjëra shumë të rëndësishme që duhet të kemi parasysh.

Së pari, praktikën e denoncimit ky Kuvend e ka të drejtë ekskluzive, sepse ne i ratifikojmë marrëveshjet dhe i prishim ato kur na vijnë argumente të mjaftueshme. Në këtë rast ne kemi argumente të mjaftueshme që vijnë si nga Ministria e Financave, por edhe nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Ashtu si kolegu im Peleshi e përmendi, në momentin kur rruga po ndërtohej, nga ana tjetër Fondi Shqiptar i Zhvillimit po bënte planifikimin për zhvillimin e rrugëve rajonale dhe lokale. Në këtë moment ne kemi dy rrugë të tjera, që janë rruga Tepelenë-Bëncë dhe rruga e Kuçit dhe Gusmarit, të cilat bëjnë pikërisht lidhjen e lotit të katërt në një rrugë alternative. Vlera e këtyre dy rrugëve është disa herë më vogël sesa vlera e marrëveshjes së kredisë të huas që kishim me Fondin Saudit. Duhet t’ju vë në dijeni, gjithashtu, se në fillim projekti i fizibilitetit për këtë rrugë kishte një kosto prej 60 milionë dollarësh, por, me rishikimin projektit, ai shkoi 45 dhe vetë marrëveshja e huas jepte vetëm 30 milionë dollarë. Pra, nevoja për të ndërtuar lotin e katërt ishte e pambuluar nga lekët që vinin nga vetë marrëveshja.

Së treti, që është shumë e rëndësishme, duke kuptuar gjithë këtë histori se si po shkante kjo hua, marrëveshja e huas, që u nënshkrua, është një procedurë administrative që zhvillohet ndërmjet Ministrisë së Financave dhe partnerëve në këtë rast. Partnerët sauditë nuk ishin përgjigjur dhe në datën 22.04.2020 ata u përgjigjën që, për sa kohë nuk e kanë bërë ende

efektive këtë hua, ajo nuk do të fillojë të zbatohet.

Duke parë të gjitha këto argumente, një gjë shumë e rëndësishme për ne në momentin kur denoncojmë këtë marrëveshje të huas është të bëjmë pyetjen: a ka një kosto financiare ky denoncim, pra, a do të paguajë shteti ndonjë dëm nga denoncimi që i bëhet huas? Në fakt, ky ka qenë një nga debatet e rëndësishme që u zhvillua në Komisionin e Ekonomisë dhe përgjigjja që erdhi ishte se kostoja financiare nga ky denoncim është zero. Domethënë, në momentin kur është menduar të realizohet kjo marrëveshje e financimit, ka qenë shumë e rëndësishme të shikohen të gjitha klauzolat, të cilat lidhen edhe me mbarëvajtjen e marrëveshjes në përgjithësi. Në kontratën fillestare dhe në rastin e denoncimit të marrëveshjes nuk ka pasur asnjë efekt financiar.

Në të gjitha këto raste mendoj se projektligji që kemi para, i cili është diskutuar dhe është komentuar gjerësisht në Komisionin e Ekonomisë me prezencën e Ministrisë së Financave, të ekspertëve dhe të drejtuesve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, mori shumicën e votave pro për të ardhur këtu. Duhet pasur parasysh edhe fakti tjetër i rëndësishëm që qeveria gjatë kësaj periudhe ka bërë premtime dhe i ka mbajtur ato, sidomos premtime që kanë të bëjnë me zhvillimin infrastrukturor dhe zhvillimin e komuniteteve të caktuara, të cilat janë udhëhequr edhe nga vlerësimi i eficiencës së fondeve të përdorura. Kështu, edhe në këtë rast vlerësimi kaloi edhe nëpërmjet procedurës së eficiencës së fondeve të përdorura dhe në mënyrë akademike ne gjykojmë se denoncimi dhe miratimi i këtij projektligji është një gjë që Kuvendi ynë, duke pasur ekskluzivitetin, duhet ta kryejë.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zonja Ekonomi!

Mbyllet diskutimi në parim për këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë në pikën tjetër: projektvendimin “Për krijimin dhe përbërjen e komisionit të posaçëm parlamentar të shqyrtimit dhe përzgjedhjes së kandidatave për organet drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionit Rregullator, Komisionit të

Ankimimeve dhe Sanksioneve, si dhe për Nënkomisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve”.

Në mbështetje të nenit 17 të Kodit Zgjedhor, Kuvendi, me propozim të kryetarëve të grupeve parlamentare, ngre një komision të posaçëm për shqyrtimin dhe për zgjedhjen e kandidatave për organet drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Nga kryetarët e grupeve parlamentare janë depozituar emrat si vijon:

Nga maxhoranca janë deputetët: Damian Gjikhuri, kryetar; Alket Hyseni, anëtar; Adnor Shamenti, anëtar.

Nga opozita janë deputetët: Myslim Murri, anëtar; Edmond Stojku, anëtar.

Komisioni do të përfundojë veprimtarinë e tij brenda datës 2 tetor 2020 dhe sipas nenit 74, pika 2, të Rregullores, do të fillojmë me diskutimet e deputetëve që janë regjistruar më parë.

Nga Grupi Socialist, për të diskutuar për këtë pikë të rendit të ditës janë regjistruar ministria, Elisa Spiropali.

Nga Grupi Demokrat janë regjistruar deputetët: Halit Valteri, Korab Lita dhe Myslim Murri.

Nga Grupi Demokraci-Drejtësi nuk ka të regjistruar.

Nga Grupi i Pavarur është regjistruar deputeti Ralf Gjoni.

Nga deputetët jashtë grupeve parlamentare janë regjistruar Kostaq Papa, Zef Shtjefni dhe Kujtim Gjuzi.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Nuk kam emra të tjerë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Zoti Balla, jo.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Këta janë emrat e deputetëve të regjistruar.

Zoti Alimadhi, për procedurë.

**Adriatik Alimadhi** – Faleminderit, zonja Hysi!

Mendoj se komisioni që do të ngrihet është i jashtëligjshëm. E para, në këtë parlament ne kemi rënë dakord të kemi komisionerë të pavarur.

E dyta, përbërja e komisionit më duket e çuditshme. Nuk kam asgjë me përfaqësuesit e maxhorancës.

Përbërja tjetër më krijon dyshime, duke parë që këtu ka parti, të cilat kanë marrë pjesë historikisht në këto 30 vjet në zgjedhje.

Unë propozoj që komisioni i posaçëm për të zgjedhur anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të bëhet me 7 anëtarë: një nga anëtarët e opozitës, nuk propozoj veten time, por të jetë kryetar i një partie tjetër, pjesëmarrës në këtë komision.

Tjetra, meqenëse këtu, nga disa kolegë deputetë, u përdor termi “ballistë”, ju lutem, përdoreni “ballistë demokratë”. Përdoreni si të doni, por juridikisht të saktë. Për “ballistët” e tjerë nuk ka të bëjë me “ballistë” jashtë linjave politike. Po ju them se është nder të kesh fjalën “ballistë”, është nder të kesh parti, sepse Partia e Ballit Kombëtar është partia e shqiptarizms. Nuk kemi të bëjmë me asgjë tjetër. Lërimi ato që fliten! Ju lutem, mos i përbaltni më, mos flisni më, që të jemi si shqiptarë, t’i japim dorën njëri-tjetrit. Në fund të fundit, ju na keni vrarë ne, na keni burgosur, na keni internuar, na i keni bërë të gjitha, por tani nuk kemi kusur t’ju dëgjojmë ju: “Ballistët janë këta...” e të tjera. Ju lutem, kërkoj një saktësim: kur dikush thotë, sipas etiketimit të regjistruar në gjykatë, thuaj “ballistë demokratë”, mos u thuaj “ballistë”.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti ...

Po, zoti Elezi, për procedurë.

**Arben Elezi** – Faleminderit, drejtuese e seancës!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Javën e kaluar u shfaqën në medie dy raste të tjera të rënda të abuzimit me të mitur, duke hapur një debat të gjerë për një shqetësim shoqëror në rritje. Vetëm në tre vjetët e fundit janë publikuar minimalisht 15 raste të bujshme të ngacmimeve dhe abuzimeve me të mitur. Më e tmerrshme është se abuzuesit, në të shumtën e rasteve, kanë qenë të fshehur pas një posti shtetëror, deri edhe të veshur me uniformën e policisë, të cilën qytetarët e paguajnë me taksa çdo ditë të vitit.

Ministri i Brendshëm, më 6 qershor të këtij viti dënoi rastin e abuzimit nga efektivi i policisë në Shkodër, duke deklaruar ashpërsimin e dënimeve për krimet seksuale ndaj të miturve, por jemi në mes të shtatorit dhe nuk kam dijeni

që ministria të ketë propozuar ndonjë strategji në këtë pikë. Ka pasur abuzime nga mësues, nga roje shkolle, në jetimore, por shteti në fund të ditës ka të njëjtat fjali: “Po hetohet për ngjarjen dhe do të përgjigjet drejtësia”. Si mund të përgjigjet drejtësia, kur ligji i jep drejtësisë një mijë hapësira për lehtësimin e dënimit? A ka struktura shtetërore për parandalimin e të paktës gjysmës së këtyre rasteve? A ka struktura komunitare në shkolla apo organe, të cilat të jenë përgjegjëse jo vetëm për krijimin e kushteve të sigurisë në mjediset e fëmijëve, por edhe për mbikëqyrjen e tyre?

Juristë të ndryshëm janë shprehur publikisht që për krime të tilla të hiqet mundësia e aplikimit të gjyqimit të shkurtuar, si dhe mundësia e aplikimit të pezullimit të dënimeve apo përfitimeve të uljes si pasojë e sjelljes së mirë.

Ne jemi të vetëdijshëm që kuadri ligjor duhet të ndryshojë. Përgjegjësia është e strukturave shtetërore, por jo vetëm, sepse duhet të ndryshojë qëndrimi ynë si shoqëri. Vërtet historia ka treguar se ne shpesh kemi një shoqëri indiferente, por jo kur bëhet fjalë për sigurinë e fëmijëve tanë.

Për mendimin tim, kjo çështje meriton vëmendje dhe përpjekje maksimale, sepse fëmijët janë më të rëndësishëm se çdo gjë tjetër për të cilën ne mund të flasim në këtë foltore.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Elezi!

Si deputete e Kuvendit të Shqipërisë, unë ju ftoj që në kuadër të grupit të deputetëve Miqtë e Fëmijëve, dhe si deputete në komisionet e përhershme parlamentare dhe në nënkomisione, të përdorim të gjitha instrumentet e kontrollit parlamentar për të ndjekur interesin më të lartë të fëmijëve kudo.

Ju e dini se ka disa nisma për parandalimin e abuzimit dhe dhunës ndaj fëmijëve.

Ju, si deputetë, mund të ndërmerri nisma për të përmirësuar legjislacionin. Rekomandimet janë mëse të qarta si nga shoqëria civile, nga ne dhe nga mekanizmat e tjerë monitorues.

Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Ralf Gjoni.

Të përgatitet deputeti Halit Valteri.

Zoti Gjoni nuk është.

Atëherë, fjalën e ka deputeti Halit Valteri.

Të përgatitet deputeti Kujtim Gjuzi.

**Halit Valteri** – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur shqiptarë,

Po mbyllet 30 vjet tranzicion dhe Shqipëria etiketohet ende nga kancelaritë perëndimore si shteti i vetëm në rajonin e Ballkanit, që nuk është në gjendje të organizojë zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Këtë verë ne ishim dëshmitarë të dy procedurave elektorale të dy vendeve fqinje. Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, dy vende me një mori problematikash, po aq sa Shqipëria, i finalizuan më së miri zgjedhjet, duke marrë vlerësimet e Bashkimit Europian, OSBE-ODIHR-it, SHBA dhe instancave të tjera, për zgjedhje të shkëlqyera.

Në të dyja këto vende triumfoi demokracia, liria e votës dhe e drejta për të zgjedhur lirisht. Në përfundim të procesit, partitë politike njohën votimet, njëra palë mori përgjegjësinë për të qeverisur njerëzit, kurse pala tjetër doli në opozitë.

E dini çfarë ndodh në Shqipëri? Prej 3 dekadash zbatohet parimi stalinist “Nuk ka rëndësi kush voton, por kush numëron”. Kush e ka bërë këtë? E kanë bërë besnikët e partive dhe militantët agresivë, që kanë marrë edhe jetë njerëzish, kanë përgjakur vendin në ditën e zgjedhjeve, duke shkaktuar një lloj turpi në sytë e atyre që na vëzhgojnë dhe drejt të cilëve duam të shkojmë, familjes së madhe europiane.

Tashmë listat e hapura morën vulën kushtetuese dhe nuk ka kthim pas. Shqiptarët e dinë shumë mirë kush i kundërshtoi listat e hapura dhe arsyen pse e bënë. Është shumë e thjeshtë, sepse nëse ndonjë politikan ose kryetar partie e ndien veten “*kingmaker*” në politikë, të dalë të mbledhë vota, të mos ketë frikë nga vota e qytetarëve dhe të mos i fshihet gjyqimit të qytetarëve si i fshihet djalli temjanit. Kjo është sfida për këta “*kingmakers-at*” e shumë partive politike, por druaj se shqiptarët do t’i ndëshkojnë, duke ditur çfarë reputacioni kanë të njerëzit e thjeshtë.

Sot po diskutojmë një çështje sensitive që, gjithashtu, meriton një analizë të hollësishme. Ka ardhur koha që militanti të qëndroje larg administrimit të procesit zgjedhor, në mënyrë që t’i japë frymëmarrje demokracisë. Nëse duam të ndjekim praktikën më të mira europiane, na duhet

një proces i depolitizuar, ku në përfundim të tij, nga palët të mos ketë arsye për të përbaltur zgjedhjet dhe të mos ngrihen tymnaja mosbesimi në adresë të njerëzve që përbëjnë komisionet zgjedhore.

Depolitizimi duhet bërë duke zhbërë militantët partiakë nga komisionet dhe duke ia besuar ato profesionistëve, njohësve të ligjit, të cilët kanë përgjegjshmërinë e duhur për pasojat ligjore në raste të abuzimit me votën. Vetëm një administratë zgjedhore e aftë profesionalisht përbën garanci për zgjedhje të lira dhe demokratike. Kush nuk pranon depolitizimin e administratës zgjedhore nuk bën gjë tjetër, veçse atentat ndaj demokracisë së vendit.

Ne e dimë mjaft mirë që kemi nga ata që i bëjnë zgjedhjet si Lukashenko. Në këtë sallë, si edhe në selinë ngjitur me këtë sallë, ka nga ata që vranë garën brenda- partiake, që manipulojnë zgjedhjet brenda partisë, që turp më të madh nuk ka. Ne nuk mund të presim që ata të bëjnë zgjedhjet e shqiptarëve. Shqipëria ka lukashenko dhe lulishenko, por ne nuk do të lejojmë të mbetet në dorë të Lukashenkos këtu pas dhe "Lulishenkos" ngjitur me ne, që kanë për qëllim ta mbajnë peng këtë vend dhe të vrasin të ardhmen e të rinjve, të vrasin shpresën dhe ëndrrën për ta bërë Shqipërinë si e gjithë Europa.

Sot duhet të jemi të gjithë bashkë vetëm për një qëllim, të mos lejojmë kthimin e Shqipërisë në duart e lukashenkove dhe lulishenkove, por të vijojmë përpara drejt perspektivës europiane, për të bërë zgjedhje të lira dhe demokratike, sipas direktivave europiane, me qëllim që të marrim sa më parë datën e anëtarësimit në Bashkimin Europian. Pas hapjes së listave ta bëjmë këtë duke depolitizuar administratën zgjedhore. Ne, si deputetë të Kuvendit, si opozitë, nuk do t'i japim votat për rehabilitimin e militantëve në krye të organit që do të organizojë zgjedhjet, prandaj koha është tani për një administratë profesioniste dhe jopolitike.

Gjej rastin t'i ftoj të gjithë kolegët e opozitës dhe të maxhorancës t'i bashkohen kësaj thirrjeje dhe t'u japim shqiptarëve mundësinë që vullneti i tyre të numërohet një për një dhe me përgjegjshmëri.

Ju faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Valteri!

Fjalën e ka deputeti Kujtim Gjuzi.

Deputeti Gjuzi nuk është i pranishëm.

Fjalën e ka deputeti Zef Shtjefni.

Të përgatitet deputeti Korab Lita.

**Zef Shtjefni** – Shumë faleminderit, zonja nënkryetare e Kuvendit!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Qytetarë,

Proceset zgjedhore në Shqipëri gjatë këtyre viteve, në pjesën më të madhe të tyre kanë qenë të manipuluar, sepse KQZ-ja ka qenë politike, duke marrë vota sa andej dhe këtej për të prodhuar deputetë të asaj force politike që do të krijonte qeverinë e radhës. Tani besoj se ka ardhur koha të zgjedhim një trupë zgjedhore, e cila duhet të zbatojë vetëm ligjin dhe jo t'i ndajë dhe t'i copëtojë votat, duke nxjerrë deputetë pa asnjë vlerë. Po ashtu, tani kërkohet që edhe partitë e vogla të hiqen, pasi gjatë gjithë këtyre viteve i kanë vjedhur partitë e mëdha dhe nuk u kanë dhënë asnjë fond, sepse na linin nga 20 vota nëpër qarqe. Tani partitë e vogla nuk u duhen më, kështu që kërkojnë t'i zhdukin edhe nga zgjedhjet, por e kanë kot.

Unë si kryetar i partisë Ora e Shqipërisë do të kandidoj në zgjedhje i vetëm dhe do ta shohim se sa vota do të marr po nuk u futën duart në procesin zgjedhor.

Një problem tjetër që dua të trajtoj, përveç kësaj teme që preka më lart, kaq kisha për të, është sektori shëndetësor, si përgjegjësi kryesor për jetën e qytetarëve tanë. Pandemia është ulur këmbëkryq në Shqipëri dhe disa ende nuk e besojnë, madje ka edhe nga kjo sallë, duke thënë se nuk ka pandemi. Në Shqipëri po vdesin përditë njerëz, ashtu sikurse po shërohen, por tani me fillimin e procesit të ri mësimor do të kemi një situatë alarmante. Gjatë fillimit të muajit gusht isha në urgjencën e qytetit të Shkodrës dhe jua them sinqerisht se kam mbetur shumë i kënaqur nga shërbimi i kryer me korrektësi, sipas protokolleve të sigurisë. Ata nuk më njohën që isha deputet i Shkodrës, pasi isha me maskë, por pashë se bënë një punë të shkëlqyer, duke u shërbyer me korrektësi të gjithë qytetarëve që kishin nevojë për vizita dhe mjekime.

Gjej rastin të falënderoj sot ministren e Shëndetësisë, edhe pse nuk është e pranishme, si dhe gjithë zinxhirin komandues dhe drejtues të mjekësisë në vend për të gjithë punën e mirë që ata bëjnë, duke u ardhur në ndihmë qytetarëve të këtij vendi.



Në fund kam një këshillë: furnizojini spitalet dhe qendrat mjekësore me medikamente, pasi kishte mangësi në furnizim. Unë jam nga ata deputetë që kur punoni mirë, jua vë në pah, ashtu sikurse, kur nuk punoni mirë, jua vë në dukje në mënyrë që në të ardhmen ta përmirësoni shërbimin ndaj qytetarëve.

Ju faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Shtjefni! Fjalën e ka deputeti Korab Lita.

Të përgatitet deputeti Kostaq Papa.

**Korab Lita** – Të nderuar kolegë,

E nderuar drejtuese e seancës,

Krijimi i këtij komisioni është konkretizimi i punës 1-vjeçare të deputetëve të opozitës për liberalizimin apo hapjen e sistemit elektoral. Sot, do të fillojë krijimi i institucioneve të reformës elektorale për zgjedhjet që do të mbahen më 25 prill të vitit të ardhshëm. Ky parlament dhe shumë institucione, duke qenë se janë prodhuar nga votat e manipuluar dhe të kontestuara gjithmonë, ka pasur edhe reagimin e qytetarëve për moscilësi apo moslartësinë e duhur, ndërsa tashmë me hapjen e listave dhe me dhënien e mundësisë qytetarëve për të zgjedhur deputetët e tyre besoj se edhe kjo e drejtë do të ezaurohet. Qytetarët duhet të jenë shumë të përgjegjshëm më 25 prill, kur të votojnë, duhet të dalin nga llogoret e tyre partiake dhe t'i japin vlerë votës së tyre, duke vënë në vend të parë njeriun.

Siç e dimë të gjithë, Presidenti ka shpallur skandencën e kësaj maxhorance, njëkohësisht ka shpallur edhe skadencën e të gjitha institucioneve, të cilat, për të hir të së vërtetës këto 7 vjet janë rrënuar, për shkak të qeverisjes nga ana e maxhorancës socialiste. Qytetarët duhet të jenë shumë të përgjegjshëm kur zgjedhin, si dhe për ofertat politike që u jepen. Siç e dimë, në mandatin e fundit Partia Socialiste doli pa asnjë ofertë politike, por me votat e marra, të gjithë e dimë se si u morën, vazhdon ende të qeverisë. Tashmë, kjo parti pa pikën e moralit u drejtohet qytetarëve për ta votuar, por, gjithsesi zgjedhja është në dorën e qytetarëve dhe për këtë nuk ka më asnjë lloj justifikimi.

Duke u nisur nga kjo gjë, për mendimin tim, meqenëse shtetit shqiptar i janë rrënuar të gjitha institucionet, duke filluar nga Presidenti, parlamenti, gjykatat dhe i gjithë zinxhirit qeverisës, do t'i bëja thirrje Kuvendit që të gjendeshin mundësitë, meqenëse e gjithë klasa

politike thotë se e do shumë Shqipërinë, institucionet dhe janë gati të sakrifkohen për ta, që më 25 prill të 2021-it të kryheshin edhe votimet për Presidentin e Republikës dhe të zgjidhej direkt nga populli (meqë Presidenti i Republikës e do shumë Kushtetutën, le ta shpallë vetë kërkesën e tij për zgjedhjen nga qytetarët)?

Po ashtu, mendoj se do të ishte mirë të kishim edhe votime për pushtetin lokal, pasi të gjithë e dimë që votimet për pushtetin lokal ishin votime dhe jo zgjedhje, pra kemi mandate të paligjshme të kryetarëve të bashkive, po ashtu kemi edhe votimet për parlamentin.

Të gjithë e dimë se e gjithë bota është angazhuar më shumë se kurrë për gjetjen e vaksinës për zhdukjen e COVID-19. Unë mendoj se këto votime në Shqipëri duhet të shërbejnë dhe të jenë vakcina për të zhdukur Katovicën 90. Sot, më shumë se kurrë, marrëveshja e Katovicës është aktuale në Shqipëri, pasi i gjithë pushteti është i mbushur me ish-punonjës të Sigurimit të Shtetit dhe kontingjent të tyre.

Po ashtu, dua t'i uroj të gjithë nxënësit për fillimin e vitit të ri shkollor, edhe pse më duket e pamundur t'u jap një urim normal në këto kushte të vështira, si dhe u uroj shumë suksese dhe të përshtaten sa më mirë me situatën e vështirë në të cilën ndodhen! Nga ana tjetër dua të denoncoj mënyrën se si ka filluar ky vit shkollor, me një formular, i cili është publikuar dhe i detyron nxënësit dhe prindërit e tyre të deklarojnë se ata nuk kanë COVID. Nuk e di se ku e ka gjetur bazën ligjore ish-ministrja e Arsimit ta detyrojë një fëmijë 7 apo 10-vjeçar që të deklarojë nën përgjegjësinë personale se nuk ka COVID, pasi këta fëmijë nuk kanë asnjë detyrim ligjor për ta bërë këtë deklaratë, aq më tepër as prindërit e tyre.

Gjithsesi, e mbështes krijimin e këtij komisioni dhe do ta mbështes deri në fund, për sa kohë ai do të prodhojë institucione të pavarura dhe të përgatitura për të përballuar një proces zgjedhor të rregullt dhe përfundimisht të kemi një proces të pranuar nga të gjitha palët dhe të depolitizuar.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Lita!

Zoti Gjuzi, jua thirra emrin dhe ju nuk ishit i pranishëm.

*(Diskutime nga salla pa mikrofon)*

Urdhëroni!

Jo, fillohet nga grupi më i vogël, fillohet nga grupi i pavarur, grupi “Demokraci”, jeni ju e pastaj me radhë.

**Kujtim Gjuzi** – Ju e dini që unë jam korrekt me procedurat.

**Vasilika Hysi** – Fjalën e ka zoti Kostaq Papa.

**Kostaq Papa** – Faleminderit!

Prej disa muajsh, edhe pas shpalljes së datës së zgjedhjeve, akoma më shumë edhe gjatë diskutimeve të sotme shihet se ka humbur sensi pozitiv-opozitiv, sepse një pjesë e mirë e opozitës prej muajsh është pozitivë. Po ashtu, duke parë edhe ndarjen e komisionit për përcaktimin dhe përzgjedhjen e kandidatave, duket qartë që kemi 4 anëtarë të pozitës dhe 1 të opozitës.

Problemi tjetër që dua të prek është se sa herë flasim për zgjedhjet, duhet të flasim edhe për emigracionin. Ne jemi të pranishëm në këtë sallë dhe askush prej nesh nuk e ka ende të qartë nëse emigracioni do të marrë pjesë në zgjedhje apo jo. Do të jetë pjesë e zgjedhjeve? Do të zgjedhë dhe do të zgjidhet? Këto ende nuk i keni sanksionuar dhe i keni lënë evazive.

Problem tjetër është se përzgjedhja e kandidatave do të bëhet në prani të përfaqësuesit të posaçëm të opozitës. Jam dakord me këtë. Pse të mos kemi edhe përfaqësues për zgjedhjen e kandidatave edhe nga emigracioni dhe diaspora, të cilët ju kanë mbajtur ju, ata dhe këta të tjerët, që kanë ikur me lekë, të cilat i keni vjedhur dhe ende nuk keni arritur të realizoni pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje si zgjedhës? Ju duhet t’i vini pikat mbi “i” sa i takon procesit që ka të bëjë me reformën zgjedhore dhe emigracioni duhet të jetë pjesë e zgjedhjeve.

Po ashtu, do të ndalem edhe në tri probleme të tjera, nëse do të më premtosh koha. Sot, në ditën e lindjes së Elmas Boçes, një firmëtar i pavarësisë nga Gjirokastra, ende nuk janë alokuar fondet për përfundimin e bustit të tij. Ju lutem, duhet ta bëni këtë gjë!

Nëse do të bëhet denoncimi për rrugën e Lumit të Vlorës, kjo rrugë duhet të bëhet, sidomos Selenica mund të dalë për 2 kilometra në rrugën Levan-Tepelenë dhe shumë fshatra mund të dalin nga izolimi, si Kotë, Drashovicë, Peshkëpi, Kuç, Sevaster, Amonicë, Mallkeq, Selenicë, Hysoverdhë, Vajzë, Vllahinë, Rexhepaj, Gorishtë dhe Karbunarë, të cilat në adoleshencën time i kam shkelur dhe i njoh,

fshatra që kanë bërë luftën, por edhe punën, qoftë edhe në diktaturë.

Një problem tjetër, duke u bashkuar me atë çka tha edhe Kryetari, duhet të bëhet një korrigjim, duke u hequr kohën e caktuar folësve që flasin me fjalime të përgatitura...

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Papa!

Ne sot po diskutojmë projektvendimin për të ngritur një komision që do të zgjedhë trupën dhe nuk po diskutojmë për detajimin e rregulloreve në varësi të detyrimeve që burojnë nga Kodi Zgjedhor. Sa i takon votës së emigrantëve, ka qenë e shprehur qartë nga kjo shumicë dhe ne e kemi votuar në ndryshimet që kemi bërë në Kodin Zgjedhor.

Prandaj, sot të votojmë përbërjen e komisionit, të ngremë strukturat dhe ata të fillojnë të nxjerrin aktet nënligjore, gjë, që do të mundësojë votën e shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë Shqipërisë.

Po, zoti Gjuzi.

Keni 2 minuta në dispozicion.

**Kujtim Gjuzi** – Edhe një herë e falënderoj nënkryetaren e Kuvendit për buonsensin që tregon, në këtë rast të rregullimit të folësve gjatë seancës plenare!

Në fakt, komisioneri, komisioni, KQZ-ja kanë gati 30 vjet që grabisin votën e shqiptarëve. Do të ketë shqiptarë komisionerë të PS-së dhe PD-së.

Zoti nënkryetar i Kuvendit, të jeni i sigurt që, nëse do të dilni në zgjedhje, nuk do të keni përfaqësues për të matur votën.

*(Ndërhyrje nga salla)*

Zoti Halit, të lutem, e kisha me nënkryetarin. Nuk je ti nënkryetari i Kuvendit.

Në këtë koncept duhet të vendosim komision jopartiak. Këtë e kërkon OSBE\ODHIR-i. Kështu do të shkojmë në Europë? Komisionerët shqiptarë do të jenë të dy partive, njëra parti jashtë parlamentit, partia tjetër brenda tij, pra PS-ja dhe PD-ja do të vendosin se çfarë do të bëjnë shqiptarët?

Në këtë kontekst, ajo që thuhet, zoti Murrizi, hapja e listave, nuk ekziston. Në Tiranë me 35 mandate, nëse do të jetë kështu, ta kesh të sigurt që mandati i 12-të, nëse do të fitojë një forcë politike si PD-ja apo PS-ja, zgjidhet përmes qytetarëve, ndërsa 11 të tjerët i zgjedh Edi Rama apo një kryetar tjetër i një partie, i cili, në fakt, është vetëm kryetari juridik i saj, se

kryetarin e vërtetë në të dy e dimë shumë mirë kush është.

Prandaj, shqiptarë, edhe një herë, mos u mashtroni nga ky moment kritik. Vetëm një qeveri pa Edi Ramën Kryeministër mund të bëjë zgjedhje në këtë vend, ndryshe zgjedhjet do të vidhen.

Konservatorët do të punojnë që të ketë qeveri transitore, mundësisht me akademikë, se ata nuk vjedhin, ata nuk janë hajdutë.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Gjuzi!

Fjalën e ka deputeti Myslim Murrizi. Të përgatitet ministrja e Shtetit, Elisa Spiropali.

**Myslim Murrizi** – Faleminderit, zonja Hysi!

Së pari, besoj se vendimi është kryer si proces votimi. Unë dua të them që më në fund në Kuvend erdhi një komision, që do të përzgjedhë një administratë, e cila do të drejtojë procesin zgjedhor të 25 prillit të vitit 2021.

Nga mediet jam njoftuar që ka pasur aplikime. Nuk dua të paragjykoj, por ndoshta për herë të parë, pas 18 muajsh, do t'i jap të drejtë zotit Gjuzi, sepse shoh që është një e shkelur syri mes dy sivëllezërve. Edhe pse në aplikime kam parë vetëm ish-komisionerë të KQZ-së dhe funksionarë, me dakordësinë tuaj shoh që aplikojnë vetëm nga krahu tjetër.

Meqenëse jemi në kushte jonormale, nuk dua të merrem shumë me komisionin, sepse duke pasur 1 votë në atë komision, nëse jam votuar si anëtar i atij komisioni nga kolegët deputetë, do të matem mirë dhe do të përzgjedh në krye të kësaj administrate prej 12 vetash, që do të drejtojë zgjedhjet e vitit 2021, njeriun më me integritet, më me moral, me karakter dhe burrëror që do të shoh në ato lista të depozituara në protokollin e Kuvendit.

Birbot dhe hyzmeqarët vëmje që komandohen me *whats app*, të paktën nga unë personalisht, por besoj edhe nga zoti Stojku, nuk do ta kenë dakordësinë time për të qenë në krye të kësaj administrate zgjedhore. Ajo që shoh, përveç administratës zgjedhore, është gufajsa e të dyja palëve, të fshehura si struci pas të famshmit Këshill Politik, një organ fantazmë, i shpikur nga hiçi, që u shua si vesa para diellit më 5 qershor, kur firmosi për moshapjen e listave. 30 korriku vërtetoi të kundërtën e 4 individëve, që 2 janë të paligjshëm dhe 2 nuk kanë moral, përderisa nuk

janë firmëtarë të ndryshimeve kushtetuese për t'u mbledhur prapë ferrave dhe të bëjnë implementimin e ndryshimeve kushtetuese në Kodin Zgjedhor.

Zoti Gjuzi, listat janë hapur 100% për ata që kanë kurajën të shkojnë dhe të votohen nga qytetarët. Jo më pak se 2/3 në parimin e së drejtës, një gjë që nuk ndalohet në Kushtetutë, lejohet. Jo më pak se 2/3 do të thotë se çdo subjekt politik që nuk ka druajtje nga vota e qytetarëve, çdo individ që ka kurajën, guximin dhe moralin që t'ia shohin surratin qytetarët, emrin, atësinë dhe mbiemrin, do të jetë në listat e hapura më 25 prill dhe çdo forcë politike, që kërkon të tjetërsojë traditën e pistë të 12 viteve të PD-së dhe të PS-së, është e lirë dhe nuk ndalohet nga Kushtetuta të marrë pjesë në garë.

*Show* i ditëve të fundit, që këta zihen se kush do t'i hapë më shumë listat, demek, është një hipokrizi bajate e dy kapove dhe pronarëve të këtyre karrigeve, falë marrëveshjes së pistë të 21 prill 2008.

Qesh kur shoh një anëtar të Këshillit Politik që thotë: “Ne jemi për hapjen e listave 100%”. Po hapi, mor zotëri, kush të ndalon?! Kush e ndalon një subjekt politik, pas 30 korrikut, të votuar në këtë sallë me 106 vota, që listat të jenë të hapura jo më pak se 2/3-at? Askush! Mirëpo ai thotë: “Nuk i hap unë, se nuk i hap sivëllai im”. Sivëllai thotë: “Unë nuk i hap dot, sepse kam hall të mbroj gjininë femërore”. E ka gabim! Ndoshta s'duhet të flas unë në emër të zonjave deputete, zonjave dhe zonjushave nga të gjitha forcat politike, që aspirojnë të hyjnë në politikë në Republikën e Shqipërisë, por duke kërkuar mirëkuptimin e tyre, do t'u thosha: “Mos u fshihni pas gishtit!”

Zonja dhe zonjusha të nderuara të këtij vendi, edhe të PS-së, edhe të PD-së, kur të kandidoni me lista të hapura, do të shihni që do të mund të merrni vota jo më pak, por shumë më shumë se burrat e pistë dhe hajdutë të kësaj salle dhe jashtë saj. Ju mos u trembni për të ruajtur zonjat, sepse ka zgjidhje 101 mijë herë nëse keni vullnet! Ju trembeni se zonjat mund të dalin para dhe ju humb krenaria false, burrërore, që nuk e keni, sepse po ta keni, shkoni te qytetarët dhe vini në këtë sallë si burra me dy “rr”, jo si “bura”. Lërin zonjat të kandidojnë! Ato kanë kuotat e tyre, këtë ua përcakton Kodi Zgjedhor. Tirana ka 35, 12 zonja le të jenë nga PS-ja, 12

nga PD-ja dhe 12 nga çdo forcë politike që do të kandidojë. E nëse fitojnë 18, sipas parashikimeve të Erion Veliajt, 6 zonja kanë garë me njëra-tjetrën. Më mirë të hyjnë me vota ato zonja, se me lista të mbyllura. Do të jenë më dinjitoze. Po, po, të jeni të bindur, që treçerekun e burrave të kësaj salle zonjat do ta mundin.

Kush jeni ju që keni të drejtë të paragjykoni zonjën Kodheli, zonjën Hyseni, zonjën Felaj, zonjën Dhima, zonjën Kushi?! Juve ju dhimbsen shumë listat e zonjave, se doni të mbani disa burra-zonja në listë, disa hajdutë, disa njerëz që kanë probleme me drejtësinë, disa që kanë firmosur tendera apriori, ca birbo, që vijnë këtu, pasi kanë firmosur projektin e Lumit të Vlorës para tre vjetësh, dhe thonë: “Më duket se dy rrugë kushtojnë më lirë se sa kjo gjë, ndaj po e anulohet”. Ndaj, mos u tallni me shqiptarët, por t’i hapim 100% listat, siç thotë Kushtetuta. Ta implementojmë Kushtetutën të plotë në Kodin Zgjedhor dhe t’u japim shqiptarëve, për herë të parë, një palë zgjedhje dinjitoze, që në këtë sallë të mos vijnë njerëz të fshehur pas fustanit të kryetarëve të partive, që kërkojnë t’ua shesin shqiptarëve nën petkun e mbrojtjes së gjinisë femërore. Hapini, hapini t’i provojmë, se do të ketë gallatë!

Edhe në perceptimin e opinionit të qytetarëve shqiptarë, burrat e pushtetshëm të këtij vendi nga 31 marsi i vitit 1991 konsiderohen hajdutë, të pistë, pazarexhinj e dallaverexhinj, që bëjnë sikur zihen ditën dhe i firmosin marrëveshjet natën.

Dëgjoni çfarë thotë opinionin publik dhe që ta përlligjini atë çfarë po them unë këtu dhe atë që thotë opinionin publik, ejani t’i hapim 100% listat dhe ato zonja të nderuara, që janë për politikë, që janë dinjitoze, të jeni të bindur që do të vijnë në këtë sallë shumë më shumë se hipokrizia e të fshehurit pas 30-përqindëshit të zonjave.

Ajo që presin shqiptarët është që, për herë të parë, humbësi të urojë fituesin. Kjo nuk ndodh nëse tre hajdutë i japin fjalën njëri-tjetrit që nuk do të vjedhin më, siç ia kanë dhënë në Këshillin Politik. Sipas këngës së Ylli Bakës: “Në një stan me bar të butë, hedhin valle tre hajdutë”, kanë lidhur besën tre hajdutë që nuk do të vjedhin votat më. Jo!

Rekomandimet e OSBE-ODHIR-it prej 10 vjetësh, prej 4 palë zgjedhësh, e kanë kusht hapjen e negociatave me Shqipërinë,

depolitizimin 100% të administratës zgjedhore, sepse me lista të hapura do të ziheni me njëri-tjetrin. Si mund t’i besojë i shtati i qarkut në Berat drejtuesit politik, kur ai do të caktojë komisionerët, që do t’i numërojë ai votat e listës së hapur me barazi, kur ai në njëfarë mënyre është i punësuar nga drejtuesi politik?!

Për komisionerët keni firmosur më 5 qershor, Damiani nuk është këtu, së bashku me Oerdin, Petritin dhe zonjën Hajdari, që do t’i bëni apolitikë, por jo në këto zgjedhje. Pse jo këto zgjedhje? “Që të shohim çfarë do të bëhet dhe pastaj zgjedhjet e tjera të ulemi e të flasim”. Jo, t’i bëjmë që në këto zgjedhje.

Tre komisionerë politikë janë politikë në 5500 qendra votimi. Në Komisionin e Reformës Zgjedhore është vetofruar Telekomit që do të montojë kamerat në çdo qendër votimi. Rezultati del në orën 00:00 të natës. Të mos bëjmë diktaturë të paktën një herë të vetme, pas 31 vjetësh, por shqiptarët ta marrin vesh fituesin që atë natë dhe të jetë një rezultat i pranuar nga palët që do të garojnë në zgjedhje. Nëse jo, numëruesit, automatikisht, sa të jem unë dhe ata kolegë që firmosën ndryshimet kushtetuese, 90 vende të numërimit të Shqipërisë nga 5 tavolina herë 3 bëjnë 1450 veta, që duhet të jenë hasëll administratë; të fuqizojmë Kodin Penal me 10 vjet burg dhe t’i përjashtojmë përfundimisht nga profesioni, që shqiptarët ta dinë që vota e tyre shkojnë atje ku numërohet.

Lojërat publike që Jani do t’i hapë 100%, por nuk i realizon dot, se ia kalon ky vëllai tjetër, janë një pallavër mediatike e stisur dhe e gjezdisur studio më studio nga eunukët, kërmijtë, që nuk vijnë dot në këtë sallë dhe nuk guxojnë se nuk kanë moral, karakter, serrat dhe dinjitet të shkojnë te qytetarët dhe të kthehen në këtë sallë nga votat e tyre.

Ju faleminderit!

*(Drejtimitin e seancës e merr zoti Ruçi.)*

**Gramoz Ruçi** – Faleminderit, zoti Murrizi!  
Urdhëro, Gjuzi!

*(Diskutim nga salla pa mikrofon)*

Të ka përmendur emrin?

**Kujtim Gjuzi** – Zoti Kryetar i Kuvendit, faleminderit!

Zoti nënkryetar, Partia Kombëtare Konservatore Albania është e gatshme që t’i hapë listat 100%. Kjo është një arritje juaja, nuk them të kundërtën. Unë nuk isha për ta firmosur

atë marrëveshje për arsye që i di kryesia e Partisë Konservatore, asambleja kombëtare. Në këtë koncept, një gjë e keni të sigurt: nëse këtu janë 10 parti politike parlamentare, që bashkë me Partinë Socialiste bëjnë 11, asnjë nga partitë politike parlamentare nuk u thirr nga Presidenti, të cilin ju e dini si e kam konsideruar, me 7 pika, dhe pse duhet të ikë.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Unë nuk kam gjë me zonjën Monika, sepse e kemi krushkë të Dibrës dhe nuk mund ta fyej këtu.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

E kemi krushkë ne tironsit, por nuk i di të gjitha gjërat ti, Korab, se je në Kamzë.

Në këtë koncept, i nderuar nënkryetar, unë do të doja nga ju që njërin nga vendet në atë komision, meqenëse jeni dy grupe aty, t'ia lëshoni njërit nga kryetarët e partive politike që janë në parlament, unë vetëpërgjashtohem, sepse kam besim te kolegët e mi, që të mos kem konflikt interesi kur diskutoj me ju. Edhe ju mund të bëni të njëjtën gjë, pra tërhiquni, lërjani Edmond Stojkut, sepse ai është doktor dhe normalisht doktorët nuk vjedhin. Ne të dy, që jemi në njëfarë mënyre me grintën e së djathtës, sjellim traditën e së djathtës, nuk kemi vjedhur kurrë, sepse për të vjedhur e di ti se kush ka vjedhur, e kemi këtu mbrapa të gjithë qeverinë dhe vazhdon të vjedhë ende. Prandaj, lëshoje atë vendin aty, lërja njërit prej kryetarëve të partive politike dhe do të kesh të gjithë mbështetjen time!

Faleminderit, zoti Murrizi!

Faleminderit, Kryetar i Kuvendit!

**Gramoz Ruçi** – Fjala për Elisa Spiropalin.

**Elisa Spiropali** – Faleminderit!

Këshilli Politik për Reformën Zgjedhore raportoi se filloi punën më 14 shtator për të reflektuar ndryshimet kushtetuese në Kodin Zgjedhor. Në fakt, nuk filloi punën, por filloi llafet, shantazhet, fyerjet dhe të zakonshmet.

Pyetjet që do t'i parashtrij tani i kam personale, jo si përfaqësuese e kësaj force politike. Për çfarë duhet më Këshilli Politik? Çfarë funksioni ka Këshilli Politik tani, kur opozita jashtëparlamentare refuzon të pranojë realitetin, që ndryshimet kushtetuese kanë kaluar në Kuvendin e Shqipërisë? Pra, ne, Kuvendi i Shqipërisë, duhet ta njohim legjitimitetin e Këshillit Politik, ndërkohë që Këshilli Politik

nuk e njeh legjitimitetin e Kuvendit të Shqipërisë. Kjo është e paparë dhe e padëgjuar. Unë kërkoj nga përfaqësuesit tanë në Këshillin Politik që të mbajnë qëndrim për këtë çështje.

Tani, në tryezë, në këtë fazë, opozita vijoi këmbënguljen, duke rënë ndesh edhe me shprehjen e njohur: “Të këmbëngulësh në të njëjtën gjë dhe të presësh rezultate të tjera, shkon vetëm në humbje”. Këmbëngulin dhe vazhdojnë të thonë se zgjidhja është ruajtja e formës së koalicioneve sipas mënyrës së vjetër.

Partia Demokratike dhe LSI-ja, opozita jashtëparlamentare, insistuan fillimisht se ndryshimet kushtetuese u kryen në shkelje të marrëveshjes së 14 janarit dhe të 5 qershorit, pra pa konsensusin e këtij Këshilli Politik. Por ndryshe nga faza kur e kundërshtonin, tani thonë se këto ndryshime nuk i pengojnë koalicionet parazgjedhore, madje kërkojnë që të mos ndryshojë formula aktuale me lista të përbëra.

Ne vijojmë të themi se ndryshimet kushtetuese kanë kaluar në parlament, janë në fuqi dhe e vetmja punë që mund të bëjë Këshilli mbetet detyrimi për të rënë dakord që ato të reflektohen në Kodin Zgjedhor. Puna e tryezës në këtë realitet të ri duhet të japë bazën e plot institucioneve që të përgatitin zgjedhjet.

Së pari, ne u kemi kërkuar që brenda të premtes të paraqesin propozimin e tyre për pragun kombëtar zgjedhor. Nuk e kemi ende, sepse nuk kanë asnjë ide mbi këtë, thjesht këmbëngulin, nuk duan të shohin realitetin, që ndryshimet kushtetuese kanë kaluar.

Së dyti, u kemi kërkuar që brenda të premtes të paraqesin afatet për paraqitjen e listës unike nga koalicionet dhe si do të kryhet aspekti procedural i votimit, opinionin e tyre për kandidatët, për listat e hapura e me radhë.

Nuk e kuptoj pse vazhdojmë t'ua kërkojmë?! E kanë refuzuar legjitimitetin e këtij Kuvendi, nuk kanë pranuar realitetin. Ne ende i pyesim: ç'do të thotë t'i drejtosh ODIHR-it një kërkesë për opinion, pavarësisht se nuk ka pyetje konkrete? Pra, kërkesa e opozitës për t'iu drejtuar ODIHR-it është jo vetëm e parakohshme, sepse ne nuk kemi ende një draft për këto çështje të përmendura më lart, por është bllokuese, në fakt, sepse e njëjta opozitë nuk pranoi rekomandimin kyç të ODIHR-it për depolitizimin e administratës zgjedhore, kur nënshkroi marrëveshjen e 5 qershorit.

Pra, as ndryshimet kushtetuese, as hapja e listave nuk kanë qenë në rekomandimet e ODIHR-it, nuk janë pjesë e rekomandimeve. Praktika është që një forcë politike e pyet ODIHR-in për rekomandimet nëse janë zbatuar ose jo, por jo për çështje që ODIHR-i nuk ka tagër. Pra, ODIHR-i nuk ka tagrin të ndërhyjë në çështjen e sistemeve zgjedhore ose të ndryshimeve kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me këto dy kushte të opozitës, maxhoranca është krejtësisht e hapur. Ndryshimet kushtetuese nuk e pengojnë hapjen e listave 100%. E kemi thënë disa herë dhe e thotë Kushtetuta. Atëherë, çfarë problemi kanë, pse e nxjerrin sërish çështjen e listave të hapura?! Bujrëm: ja sheshi, ja mejdani! Le të dalë Oerd Bylykbashi, Petrit Vasili e të tjerë dhe të votohen! Votohen, nuk votohen apo refuzohen Petriti, Oerdi, Nardi apo një listë e përbërë nga ku e di unë cilet njerëz të tjerë të këtij koalicioni, nuk është problemi ynë. Pse, problemi ynë është që këta kanë frikë të dalin dhe të përballen me emrin, fytyrën e tyre dhe me listën e tyre?! Nuk është problemi ynë, madje nuk është as problemi i Kushtetutës, as i shtetit, as i qytetarëve. Hallet e tyre individuale të mos ua hedhin në kurriz qytetarëve!

Për më tej, ne jemi të vendosur që ndryshimet kushtetuese t'i reflektojmë në ligjin zgjedhor, në Kodin Zgjedhor, e kemi detyrim këtë dhe do ta bëjmë patjetër. Kanë kohë deri nesër të sjellin propozimet e tyre për këto tri çështje. Nuk është ultimatim, është një kërkesë e arsyeshme. Janë ata që vazhdimisht vendosin ultimatime të pamundura dhe kërkojnë t'i imponohen një institucioni kushtetues me një Këshill Politik, për të cilin ne kemi rënë dakord në mënyrë që ata të mos mbeteshin në këmbë.

Nuk janë pjesë e institucioneve, kanë refuzuar. Zgjedhjet politike kanë edhe pasoja, të cilat nuk mund t'i vuajmë ne dhe qytetarët, pasojat duhet t'i vuajnë ata për vendimet që kanë marrë.

Të kthehen, ne jemi të gatshëm t'i dëgjojmë, por nuk ka punë ODIHR-i këtu dhe nuk ka punë asnjë institucion tjetër, ka punë Kuvendi, i cili, përmes votimit sot të komisionit, do të bëjë të mundur që brenda 30 shtatorit të kemi më në fund një Kod Zgjedhor, një listë zgjedhore dinjitoze.

**Gramoz Ruçi** – Zoti Murrizi, keni fjalën.

**Myslim Murrizi** – Faleminderit!

E nderuar zonja Spiropali,

Kuvendi i Shqipërisë dhe Komisioni i Ligjeve, në të drejtën e tij kushtetuese, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, pardje ka krijuar një komision për të bërë implementimin e ndryshimeve kushtetuese në Kodin Zgjedhor, i përbërë nga zoti Gjikhuri, Klotilda Ferhati dhe Korab Lita.

Pyetjen pse ata mblidhen ferrave, është e nevojshme ta bësh me ne, sepse ne nuk kemi përfaqësues te ferrat!

Thojini Gjikhurit që mund të dalë në televizor edhe duke u mbledhur me Korabin dhe Klotildën në parlament, lë të ftojë kë të ketë qejf nga ata, siç do të jetë një komisioner ekstra, jashtëparlamentar, zoti Bylykbashi, në komisionin që është votuar, le të vijë dhe t'i bëjnë propozimet aty. Çfarëdolloj çorbe që të gatuajnë ata në bodrumet e Pallatit të Kongreseve, do të detyrohen ta lëprijnë mbrapsht njëlloj si 5 qershorin e famshëm, kur firmosën që ne katër agallarët nuk marrim përsipër të hapim listat, por e vërteta është krejt ndryshe, se 106 deputetë të Kuvendit vendosën më 30 korrik hapjen e listave.

Ndaj ftoj komisionin e ngritur nga Komisioni i Ligjeve, Gjikhurin, Klotildën dhe Litën, të mblidhet së bashku me të gjitha grupet parlamentare dhe faktorë të tjerë politikë jashtë sallës së Kuvendit, të depozitojnë propozimet e tyre në përputhje me Kushtetutën e re në Kodin Zgjedhor.

Sa u përket dënglave të rekomandimeve, unë mendoj se OSBE-ja dhe ODIHR-i kanë folur qartë para një viti, kur janë takuar në Komisionin e Reformës Zgjedhore. Ata kërkojnë administratë zgjedhore në 5508 qendrat e votimit të Shqipërisë, që dorë militanti të mos kapë më votën e qytetarëve shqiptarë. Nëse i duan, bujërëm, hajdeni t'i votojmë, jua kërkoja edhe më parë juve, si maxhorancë.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Këtu mbyllem çështjet që kishim për të shqyrtuar sot. Në mbështetje të nenit 61, pika 2 të Rregullores, më lejoni të komunikoj rezultatet e votimit për çështjet si më poshtë:

Për projektligjin “Për aderimin në amendamentin DOHA të Protokollit të Kiotos të

Konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike, aderuar me ligjin nr. 9334, datë 16.12.2004”, rezultati i votimit në parim është: 101 vota pro, 1 votë kundër, 3 vota abstenim; rezultati i votimit në tërësi është: 101 vota pro, 1 votë kundër, 4 vota abstenim.

Miratohet.

Për projektligjin "Për denoncimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim, për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”, ratifikuar me ligjin nr. 100/2017” rezultati i votimit në parim është: 84 vota pro, 14 vota kundër, 7 vota abstenim; rezultati i votimit në tërësi është: 83 vota pro, 14 vota kundër, 10 vota abstenim.

Miratohet.

**Sekretar i Sekretariatit për  
Procedurat, Votimin dhe Etikën**

**Alket Hyseni**

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve  
Parlamentare  
Krenar Hajdëri**

Për projektvendimin “Për krijimin dhe përbërjen e komisionit të posaçëm parlamentar për shqyrtimin dhe përzgjedhjen e kandidaturave për organet drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, komisionerit shtetëror të zgjedhjeve, komisionit rregullator, komisionit të ankimimeve dhe sanksioneve, si dhe për nënkomisionerin shtetëror të zgjedhjeve, rezultati i votimit është: 95 vota pro, 5 vota kundër, 3 vota abstenim.

Miratohet.

Këtu mbyllet seanca.

Seanca tjetër do të njoftohet nëpërmjet medias.

Faleminderit!

Ditën e mirë!

*(Seanca u mbyll në orën 13:15)*

**Kryetari i Kuvendit**

**Gramoz Ruçi**